# Buletini Këshillit Ankesave.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

DHJETOR 2016

© AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

# Përmbajtja

Parathënie ........ 04

Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave ........ 07

**SEKSIONI I**
Ankesa me subjekt cenimi i të drejtave të fëmijëve ........ 11

**SEKSIONI II**
Ankesa me subjekt cenimi i rregullave të etikës ........ 33

**SEKSIONI III**
Ankesa të tjera ........ 42

**SEKSIONI IV**
Letra të Hapura ........ 49

**SEKSIONI V**
Ankesat të rrëzuara ........ 55

**SEKSIONI VI**
Anketë mbi performancën e Kodit të Transmetimit........ 60

Parathënie

*"Cdo person ka të drejtë të kërkojë, të hetojë, të pyesë, të marrë dhe të ndajë informacion, mendime dhe ide, pa asnjë lloj censure përmes radios, TV dhe mjeteve të tjera të komunikimit audioviziv apo ndonjë procedure tjetër bazuar në përzgjedhjen e tij, vetëm nëse këtë e bën në kuadër të respektimit të sundimit të ligjit dhe të të drejtave të njeriut. Kjo e drejtë ka të bëjë me krijimin e shërbimeve të masmedias".*

Ky parim përbën një prej disa standarteve më të avancuara ndërkombëtare i cili garanton diversitetin dhe pluralizmin në shërbimet e komunikimit në transmetimet audiovizive. Ai përmbledh nivelet më të larta ndërkombëtare në lidhje me cështjet e lirisë së shprehjes dhe të së drejtës për informim, parashtruar në konventat e të drejtave të njeriut, në deklaratat dhe rekomandimet që vijnë prej sistemeve të ndryshme ndërkombëtare.

Bazuar mbi këto principe është hartuar dhe legjislacioni në fuqi sa i përket Ligjit për Mediat Audiovizivë në Republikën e Shqipërisë, i cili garanton që në veprimtarinë audiovizive të moscenohet rendi kushtetues, sovraniteti dhe integriteti kombëtar; e drejta e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive; dhe konkurrenca e ndershme. Nisur që këtej, mbështetur në Kodin e Transmetimit të miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive i cili përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikat e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, Këshilli i Ankesave ka detyrën të vëzhgojë me kujdes se si këto standarte të mirëpërcaktuara për përmbajtjen në transmetimet audiovizive zbatohen.

Buletini i Këshillit të Ankesave i cili prej disa kohësh ka qenë i munguar në tregun audioviziv si këshillues i përmbajtjes së programeve audiovizive, është një dokument zyrtar në të cilin raportohen rezultatet e ankesave të shqyrtuara nëpërmjet të cilave dyshohet se janë shkelur parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikat e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Shqipëria po jeton një prej zhvillimeve më progresive në tregun audioviziv.

Por e vërteta është se ajo ka shënuar skena zhvillimi ndryshe nga sektorët e tjerë që nga fazat e hershme.

Megjithatë, pavarësisht nga progresi i pamohueshëm, cënimi i normave dhe rregullave të etikës nuk mungojnë. Një pjesë e gazetarëve në dhomat e lajmeve e perceptojnë lirinë e shprehjes, ndryshe nga sa ajo perceptohej vite më parë sa i përket respektimit të Kodit të Etikës në profesionin e tyre dhe Kodit të Transmetimit. Ajo që konstatohet prej së largu duket se vetë gazetarët janë në dijeni të situatës, por atyre u mungon nxitja dhe dëshira për ta përmirësuar atë. Në mënyrë të ngjashme, po aq edhe pronarët e medias, nuk duket të jenë veçanërisht të interesuar në nxitjen e zbatimit të standarteve të vendosura e që janë thuajse të njohura prej vetë atyre, gazetarëve por dhe opinionit publik.

Në shumë prej tyre nuk ekzistojnë as formacionet me bordet e tyre etike të këshillimit, me rolin e tyre rregullator ndaj veprimtarisë gazetareske apo editoriale të përmbajtjes së programit. Funksionimi i tyre krijon mundësinë e vëzhgimit dhe e zbatimit më me rigorozitet të Kodit të Transmetimit të AMA-s, por dhe ligjit për mediat, hartuar të dy mbi standartet europiane të legjislacionit në fuqi. Nisur prej këshillimeve të ekspertëve ndërkombëtare por dhe përvojave më të mira të rregullatorëve, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Ankesave në vecanti, janë të prirur megjithë përshkrimin e kësaj situate më lart, të nxisin disa aktorë për t'u përfshirë në diskutimin e mundësive për të krijuar një praktikë efektive të vetë-rregullimit të situatës etike në tregun audioviziv.

Megjithë vështirësitë dhe pengesat që hasen rrugës për shkak të një tregu jo fort të konvergjent referuar parimeve etike mes palëve, përpjekjet tona kohët e fundit kanë pasur një natyrë insistuese, energjike dhe të bashkërenduar me aktorë të tjerë, në përmirësimin e situatës sa i përket ndërgjegjsimit të saj.

Në adresën e Autoritetit të Mediave Audiovizive që prej muajit prill kanë mbërritur më shumë se 20 ankesa, 10 prej të cilave kanë pasur për subjekt cështjen e trajtimit të të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive.

Dhjetra reagime lidhur me këtë temë kanë mbërritur sidomos nga rrjetet sociale, konsiderueshëm edhe nga institucione publike dhe organizata joqeveritare. Ankesat e tjera në lidhje me cenimin e normave etike kanë pasur një numër më të ulët. Cështja e publikimit të të dhënave sensitive të fëmijëve ka qenë ndër shqetësimet e vazhdueshme në trajtimin e ankesave me përmbajtje të tillë nga Këshilli i Ankesave.

Në të gjitha shoqëritë mjetet e komunikimit audioviziv, si radio apo dhe televizioni luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e publikut, në krijimin dhe respektimin e një imazhi pozitiv të qenieve njerëzore, duke përfshirë edhe fëmijët. Duke pasur parasysh këtë detyrë, media në emër të informimit publik të ngjarjeve që ndodhin, në emër të së vërtetës dhe të paanshmes ka cenuar disa parime dhe norma etike që kanë ndikuar tek fëmijët negativisht, duke shkaktuar madhe dhe gjendje post-traumatike.

Media dhe produktet e saj audiovizive duhet t'i shërbejnë mirëqenies së fëmijëve dhe angazhimit të të gjithë aktorëve përgjegjës për ta, në një shoqëri demokratike. Media nuk duhet të publikojë ose transmetojë çdo material që vjen prej terrenit. Ai duhet të analizohet dhe shqyrtohet para se të transmetohet nëse cenon apo jo të drejtat e fëmijëve dhe se çfarë pasojash sjell ai për zhvillimin e tij mendor e psikologjik pas transmetimit. Ajo sigurisht duhet të ketë kujdes të publikojë ngjarje dhe histori të cilat paraqesin shembuj dhe modele pozitive. Sa i përket raportimit të ngjarjeve të rënda kriminale ato duhet të raportohen vetëm nëse përbëjnë interes publik dhe asnjëherë nuk duhet të trajtohen si tendencë për sensibilizim.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në mjedisin e sotëm të transmetimeve audiovizive mbetet një shqetësim i vecantë dhe përfaqson një sfidë jo pak të lehtë.

Sigurisht kundrejt rolit edukues që media ka, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është thelbësore në përmbajtjen e emetimit të programeve televizive. Në vecanti këto kërkesa shtrohen para transmetuesit publik tek i cili besimi për të ofruar një shërbim me përmbajtje vlerash dhe normash, ka pasur gjithmonë një pritshmëri më të lartë.

Nisur prej cënimit herë pas here të të drejtave të fëmijëve në transmetuesit audiovizë apo dhe shkeljeve që janë shenjuar sa i përket të drejtës së privacisë dhe të tjerave që kanë përbërë po aq cënim të rregullave etike sa i përket moralit në shoqërinë shqiptare, për Këshillin e Ankesave kanë përbërë shqetësim sa i përket zbatueshmerisë së legjislacionit në fuqi. Ndaj në këtë epokë të re të teknologjisë së avancuar dhe situatës konvergjente në të cilën ndodhet media me zhvillimet teknologjike, zgjidhja më e mirë që mund të ofrohet është bashkëpunimi i frytshëm për të ngritur një sistem të përbashkët pune, për cështje kaq të ndjeshme sic është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive.

Por nuk duhet ta heqim nga vëmendja se cështja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nuk është vetëm ndërmarrja e disa masave teknike, as edhe e sanksioneve të forta ligjore për t'i mbrojtur ata prej disa të drejtave që gëzojnë dhe që ruhen me ligje ndërkombëtare por ka dicka më shumë se kaq më tej. Është një kombinim kërkesash i autoriteteve rregullatore që bazohen tek; prodhimi i përmbajtjes së duhur që emetohen në to; edukimi cilësor mbi median dixhitale dhe ndarja e përgjegjësive mes aktorëve të ndryshëm. Në këtë rast bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm.

Mbrojtja e fëmijëve prej influencës së dëmshme të përmbajtjes së programeve mbetet një cështje shumë shqetësuese për prindërit, për median vetë dhe rolin që ajo duhet të ketë, gjithashtu dhe strategjitë që duhet të ndiqen për të mbrojtur të drejtat që ata gëzojnë.

# Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin Nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 për Mediat dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë, duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankese dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikat e përcaktuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: *www.ama.gov.al*
Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "Formular ankese për shkeljen e Kodit të Transmetimit", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: *info@ama.gov.al*

Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankese që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet Buletini i Këshillit të Ankesave. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.

Në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive kanë mbërritur ankesa nga institucione shtetërore, organizata joqeveritare dhe individë të ndryshëm. Këshilli i ka vërejtur dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha ankesat, duke i argumentuar përgjigjet e tyre dhe vendimet për to, bazuar mbi nenet dhe rregullat e hartuara në Ligjin për Mediat Audiovizive, Nr. 97/ 2013.

Prej tyre, çështjet ankuese më sensitive kanë qenë ato rregulla dhe parime, shkelja e të cilave përbën cenim të të drejtave të të miturve në transmetimet audivizive. Kujtojmë se Kodi i Transmetimit, ndër parimet themelore të tij, ka garantimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtën absolute të tij për privatësi.

Nga dhjetra ankesa, disa prej tyre kanë pasur për objekt pikërisht cenimin e të drejtave të të miturve të cilave, Këshilli u është përgjigjur menjëherë duke u sjellë vazhdimisht në kujtesë operatorëve audiovizivë përmbajtjen e rregullave të Kodit të Transmetimit.

Çështje të tjera të trajtuara janë ato me objekt shkeljen etike në transmetimet audiovizive, përkatësisht, cenimin e dinjitetit dhe privacisë, tw tjera mbi Të Drejtat e Autorit, të cilat nuk kanë qenë kompetencë e Këshillit të Ankeave dhe, si rrjedhojë, u janë kaluar Drejtorive të tjera në AMA, në rastet konkrete Drejtorisë së Mbikëqyrjes.

Gjithashtu, në Autoritetin e Mediave Audivizive kanë mbërritur edhe Letra të Hapura me objekt marrjen e masave për zbatimin e Kodit të Transmetimit, të cilat i janë kaluar për shqyrtim Këshillit të Ankesave, si struktura që ka kompetencën të vrojtojë zbatimin e këtyre akteve nënligjore të hartuara nga AMA; si dhe ankesa që nuk janë konsideruar të tilla, bazuar mbi rregullat dhe aktet nënligjore të përfshira në Kodin e Transmetimit.

Vendimet lidhur me këto ankesa janë marrë gjatë mbledhjeve që Këshilli i Ankesave ka kryer në 6-mujorin e dytë të vitit 2016.

Këshilli i Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive bazuar mbi detyrën funksionale të tij ka kërkuar që të kryhet edhe një anketim modest mbi perfomancën e Kodit të Transmetimit. Ai i besoi Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës zbatimin e metodologjisë mbi hulumtimin e tregut për të përcaktuar qëndrimet e publikut ndaj një sërë çështjesh me rëndësi dhe tepër sensibilisuese për të.

Për të pasur një rezultat sa më afër të vërtetës reale lidhur me perfomancën e Kodit të Transmetimit nga ana e subjekteve audiovizive, metodologjia e këtij anketimi u mbështet kryesisht në parimin e krahasimit dhe kryqëzimit të të dhënave.

Anketa, rezultatet e së cilës po ju prezantojmë, synoi të sigurojë një perceptim tërësor mbi situatën aktuale të medias në Shqipëri, e në veçanti mbi punën e gazetarëve; lirinë që ata kanë për t'u shprehur; raportin e ekranit me qytetarët dhe aksesin e këtyre të fundit, interferencat politike në televizione, etj.

# 1

# Ankesa me subjekt cenimi i të drejtave të fëmijëve

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Ministria e Mirëqenies Sociale dheRinisë**

Nr. prot. 93

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
| --- | --- | --- |
| **Televizioni News 24** | **Informativ** | **11.04.2016** |

## 1. Programi

Programi përfshin informacione të ndryshme nga vendi dhe bota, intervista dhe biseda në studio, etj. Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionin informativ të këtij subjekti audioviziv. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është publikimi i të dhënave sensitive lidhur me rastin e një fëmije.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Gjithashtu, ajo bazohet në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, germa dh); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audivizive (AMA), miratuar në 27 janar 2014, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sjell në vëmendje rastin e një fëmije të mitur 19 muajsh, nga fshati Kllobçisht i Dibrës. Fëmija qëndronte vetëm gjatë gjithë ditës në banesë, pasi nëna e kishte braktisur. Ndërsa i ati i fëmijës endej rrugëve në kërkim të një pune. Sipas ankesës, Televizioni News 24 ka publikuar pamje të banesës ku qëndronte fëmija dhe pamje të foshnjës, pa marrë masa për mbulimin e fytyrës.

Bazuar sa më sipër, ankuesi thekson se publikimi i lajmit, me të dhëna sensitive, përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu veçanërisht, të drejtën e konfidencialitetit dhe privacisë së fëmijëve. Sipas Agjencisë, raportimi i ngjarjes bën të mundur identifikimin në mënyrë indirekte të fëmijës viktimë përmes publikimit të detajeve të sipërcituara.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas ankesës së paraqitur nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe të Rinisë, shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi cenim të Kodit të Transmetimit të AMA-s, konkretisht të seksionit 1, "Parime Themelore", pikat 1.3, 1.4, 1.17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetime audiovizive", pika 5.1, 5.2 dhe 5.3, për mosrespektim të të drejtave të të miturve në programet informative.

Parimet themelore kërkojnë nga operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, që gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, të garantojnë dhe respektojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit. Në transmetimet e tyre audiovizive ato duhet të respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Në Kodin e Transmetimit, "Fëmijët në transmetimet audiovizive" Seksioni 5, pika 5.1 përcaktohet qartësisht se, OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale.

Gjithashtu, në pikën 5.2 të këtij seksioni thuhet: "...duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare". Më tej, në pikën pasardhëse të Kodit të Transmetimit 5.3, në po këtë seksion, shkruhet qartazi: "Në rastet e parashikuara në pikat 5.1 dhe 5.2 më sipër, duhet përdorur teknologjia e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të fëmijës".

Nisur nga kjo, gjatë shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave vuri re se nuk është respektuar asnjë nga kërkesat e mësipërme të Kodit të Transmetimit. Që këtej, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s vendosi t'i tërheqë vëmendjen Televizionit News 24, mbështetur në nenin 33, germa dh), të ligjit numër 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1 "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetime audiovizive", pika 5.1, 5.2 dhe 5.3, konkretisht për mosrespektim të të drejtave të të miturve në programet informative.

Duke rikujtuar se kuadri legjislativ dhe rregullator për mediat audiovizive përcakton qartë përgjegjësitë e mediave ndaj respektimit të të drejtave të fëmijëve, Këshilli i Ankesave kujton se OSHMA-të kanë detyrimin ligjor të ndalojnë transmetimin e programeve që çojnë direkt apo indirekt në identifikimin e të miturve, të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar apo i akuzuar për kryerjen e një vepre penale.

Ankesa e paraqitur: **Reagime të shumta në rrjetet sociale**

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni News 24** | **Informativ** | **19.05.2016** |

## 1. Programi

Programi përfshin informacione të ndryshme nga vendi dhe bota, intervista dhe biseda në studio, etj. Reagimet, më së shumti në rrjete sociale, erdhën pas intervistimit në studion televizive, në kohë reale, të 5 fëmijëve, nxënës të një shkolle në Cërrik. Ata u intervistuan me pamje dhe zë, dhe nga sa u kuptua dhe u pranua prej vetë nxënësve, pa dijeninë e prindërve.

## 2. Kategoria

Ankesat u mbështetën mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Gjithashtu, ankesat u bazuan në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 4, germa b); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audivizive, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.4, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pikat 5.1, 5.2, 5.3 dhe 5.5 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhje e ankesës

Ankuesit theksonin se, nisur nga intervistimi në studio, në kohë reale i 5 nxënësve të mbërritur në Tiranë nga një shkollë e Cërrikut, shprehnin shqetësimin për identifikimin e tyre të plotë, me zë dhe më figurë. Gjithashtu, shqetësimet lidheshin dhe me përdorimin e fëmijëve nga dy palë në konflikt me njëra-tjetrën, si dhe me intervistimin e tyre pa dijeninë e prindërve. Pra, ankuesit nënvizonin disa shkelje: identifikimin e të miturve, shkeljen e të drejtave dhe privatësisë së tyre, si dhe intervistimin e të miturve pa dijeninë e prindërve.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas reagimeve të shumta, kryesisht në rrjete sociale, Këshilli i Ankesave ka vëzhguar në datën 19.05.2016 bisedën në studio me 5 fëmijët e mitur, të cilët prononcohen mbi një rast të pretenduar të ushtrimit të dhunës nga mësuesja e tyre në qytetin e Cërrikut. Më pas, e gjitha kjo u përmblodh në një kronikë lajmesh në edicionet informative në televizionin News 24.

Pas shqyrtimit të materialeve filmike, Këshilli i Ankesave konstatoi, shkelje të rënda të Ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit.

Pavarësisht se nxjerrja e fëmijëve kishte për synim denoncimin e dhunës së një mësueseje, kjo nuk e përligjte aspak shkeljen e Ligjit e të Kodit të Transmetimit dhe përdorimin e fëmijëve, për shkak të një konflikti mes dy palëve të tjera, si në rastin konkret.

Konkretisht, neni 4, pika 1, germa b) i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" përcakton qartësisht se "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.

Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve", dhe pika 5.1 e Kodit të Transmetimit përcakton se"OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale". Në transmetimin e televizionit News 24, pavarësisht mbulimit të fytyrës së fëmijëve në kronikën e lajmeve, ata u identifikuan nga publikimi i plotë i emrave të tyre, zëri, qyteti dhe shkolla.
Një tjetër shkelje e Kodit të Transmetimit është edhe mosinformimi i prindërve të tyre. Bazuar në pikën 5. 10 të Kodit të Transmetimit, ku thuhet shprehimisht se "intervistimi i fëmijëve duhet të bëhet me praninë ose të paktën me dijeninë e përfaqësuesit të tij ligjor ose një personi të caktuar prej tij", konstatuam se ky publikim i të dhënave të të miturve, pa pëlqimin e prindërve apo përfaqësuesit ligjor, është i ndaluar dhe përligjet vetëm në rast të një interesi të madh publik.

Mbështetur në nenin 133, referuar nenit 33, germa dh) i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe në Kodin e Transmetimit, seksioni 1 "Parime Themelore", 1.3, 1.4, 1.17, seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1, 5.2, 5.8, seksioni "Intervistimi i fëmijës", pikat 5.10 deri tek 5.20, AMA vendosi t'i tërheqë vëmendjen televizionit News 24 për të mos përsëritur raste të tilla.

AMA i kërkoi gjithashtu operatorit televiziv në fjalë heqjen e videos përkatëse nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**
**Ministria e Mirëqenies Sociale dheRinisë**

Nr. prot. 153

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni Klan** | **Emisioni "Zonë e lirë"** | **31.05.2016** |
| **Televizioni Ora News** | **Edicioni i lajmeve** | **31. 05. 2016** |

## 1. Programet

Programi "Zonë e lirë" është një emision me karakter gjeneralist dhe mbështetet mbi aktualitete të ndryshme, politike, sociale dhe kulturore, lokale e ndërkombëtare, duke i përcjellë ata nëpërmjet personazheve që ideatori dhe drejtuesi i emisionit fton në studio. Këto personazhe janë protagonistë direkt ose indirekt të këtyre ngjarjeve. Promovimi është në thelb te intervistat që zhvillohen në studio. Politikanë, artistë, shkrimtarë, gazetarë, shkencëtarë janë autorë ose "viktima" të ngjarjeve apo ndodhive të ndryshme, duke rrëfyer historitë e tyre. Programi përfshin informacione të ndryshme nga vendi dhe bota, intervista dhe biseda në studio etj.

Edicioni i lajmeve në televizionin Ora News përfshin informacione të ndryshme nga vendi dhe bota, intervista dhe biseda në studio, etj. Ankesa për dy operatorët televizivë lidhet me publikimin e të dhënave sensitive lidhur me rastin e një fëmije nga Qendra Rezidenciale në Shkodër.

## 2. Kategoria

Ankesa bazohet në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, germa d); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audivizive (AMA), miratuar në 27 janar 2014, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.7, seksioni 4, "Transmetimi i programeve informative", pika 4.8, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", nënseksioni "Programet kulturore argëtuese, filmat dhe fëmijët".

## 3. Përmbledhje e ankesës

Shkresa e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i referohet publikimit të një letre që, një fëmijë nga Qendra Rezidenciale në Shkodër i ka dërguar Kryeministrit të vendit, z. Edi Rama lidhur me abuzimin që ka përjetuar në qendër, si dhe kërkesën për të ndihmuar familjen e saj. Letra është publikuar, në lajmet e datës 25. 05. 2016 në kanalin televizin Ora News, dhe në datë 27. 05. 2016, në emisionin "Zonë e lirë" në kanalin televiziv Klan.

Agjencia mbështet plotësisht shqetësimin dhe problematikat që trajtonte letra, dhe bënë me dije se, si institucion është pjesë e planit urgjent të masave që ka ndërmarrë Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me situatën. Megjithatë, thekson se, në respekt të të drejtave të fëmijës për ruajtje të kofidencialitetit dhe të privacisë, të së drejtës për korrespondencë, parime dhe detyrime ligjore të sanksionuara në Konventën e OKB "Për të Drejtat e Fëmijës", dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", letra e 12-vjeçares nuk duhej botuar e plotë, aq me tepër faksimilja e saj. Agjencia vë në dukje se, në faksimilen e letrës së publikuar, ku duket qartë emri i vajzës, janë publikuar gjithashtu të dhëna sensitive të jetës së vajzës në institucion, me interes për strukturat që merren me mbrojtjen e fëmijëve, por jo për opinionin publik. Po ashtu, është publikuar emri dhe fytyra e nënës së vajzës, që e bën dhe më të qartë identifikimin e vajzës së mitur.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas shkresës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe të Rinisë, shqyrtoi materialet filmike dhe konstatoi se:

-Në emisionin "Zonë e lirë", e mitura identifikohet me emër dhe mbiemër, duke i cituar moshën, por pa shfaqur imazh dhe audio të saj në ekran. Nëpërmjet leximit të plotë të letrës nga moderatori gjatë emisionit, identifikohen gjithashtu me emër, edhe motrat më të mitura të vajzës, që ka shkruar letrën.

-TV Ora News, në kronikën e transmetuar, ka shmangur treguesit e shfaqjes së identitetit të 12-vjeçares apo përshkrim të detajuar me zë dhe figurë, që çon direkt apo indirekt në identifikimin e saj. Në faksimile, ku megjithëse nuk duket qartë emri i vajzës, janë publikuar të dhëna sensitive të jetës së saj në këtë institucion. Bën përjashtim vetëm fakti që emri i fëmijës lexohet me vështirësi në momentet që faksimilja e letrës transmetohet në ekran.

Këshilli i Ankesave vuri në dukje që, edhe pse publikimi i letrës, pas shpërthimit të atij u konsiderua si skandal në Qendrën Rezidenciale në Shkodër, përbën interes publik për një çështje, që tashmë është edhe nën hetim nga strukturat përkatëse, në dy rastet e publikuara ka shkelje të Ligjit 97/2013 dhe të Kodit të Transmetimit.

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave vendosi t'ju tërheqë vëmendjen dy operatorëve televizivë, mbështetur në nenin 33, germa dh), të ligjit numër 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimeaudiovizive", pika 5.1, 5.2 dhe 5.3, për mosrespektim të të drejtave të të miturve në programet informative.

Kuadri legjislativ dhe rregullator për mediat audiovizive përcakton qartë përgjegjësitë e mediave në respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Në mënyrë të veçantë, ato kanë detyrimin ligjor të ndalojnë transmetimin e programeve që çojnë direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar apo i akuzuar për kryerjen e një vepre penale.

Parimet themelore, të sansksionuara në Kodin e Transmetimit, kërkojnë nga operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, që gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, të garantojnë dhe respektojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit. Në transmetimet e tyre audiovizive duhet respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

*Seksioni 5 përcakton qartësisht:*

5.1 OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale.

5.2 Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare.

5.3 Në rastet e parashikuara në pikat 5.1 dhe 5.2 më sipër, duhet përdorur teknologjia e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të fëmijës.

Duke rikujtuar se kuadri legjislativ dhe rregullator për mediat audiovizive përcakton qartë përgjegjësitë e mediave ndaj respektimit të të drejtave të fëmijëve, Këshilli i Ankesave rikujton se OSHMA-të kanë detyrimin ligjor të ndalojnë transmetimin e programeve që çojnë direkt apo indirekt në identifikimin e të miturve, të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar apo i akuzuar për kryerjen e një vepre penale.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni Klan** | **Emisioni "Stop"** | **16.06.2016** |

## 1. Programi

Programi trajton tema sociale nga realiteti shqiptar dhe probleme të ndryshme të qytetarëve, të cilët kërkojnë zgjidhje për hallet e tyre. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është mosrespektim i të drejtave të të miturve në transmetimet televizive, shkelje e etikës dhe privatësisë, me pasojë identifikimin e tyre te drejtpërdrejtë.

## 2. Kategoria

Ankesa bazohet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Gjithashtu, ankesa bazohet në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, germa dh); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audivizive (AMA), seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhje

Shkresa e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i referohet publikimit të një letre që, një fëmijë nga Qendra Rezidenciale në Shkodër i ka dërguar Kryeministrit të vendit, z. Edi Rama lidhur me abuzimin që ka përjetuar në qendër, si dhe kërkesën për të ndihmuar familjen e saj.

Letra është publikuar, në lajmet e datës 25. 05. 2016 në kanalin televizin Ora News, dhe në datë 27. 05. 2016, në emisionin "Zonë e lirë" në kanalin televiziv Klan.

Agjencia mbështet plotësisht shqetësimin dhe problematikat që trajtonte letra, dhe bënë me dije se, si institucion është pjesë e planit urgjent të masave që ka ndërmarrë Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me situatën. Megjithatë, thekson se, në respekt të të drejtave të fëmijës për ruajtje të kofidencialitetit dhe të privacisë, të së drejtës për korrespondencë, parime dhe detyrime ligjore të sanksionuara në Konventën e OKB "Për të Drejtat e Fëmijës", dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", letra e 12-vjeçares nuk duhej botuar e plotë, aq me tepër faksimilja e saj. Agjencia vë në dukje se, në faksimilen e letrës së publikuar, ku duket qartë emri i vajzës, janë publikuar gjithashtu të dhëna sensitive të jetës së vajzës në institucion, me interes për strukturat që merren me mbrojtjen e fëmijëve, por jo për opinionin publik. Po ashtu, është publikuar emri dhe fytyra e nënës së vajzës, që e bën dhe më të qartë identifikimin e vajzës së mitur.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shkresës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave tëFëmijëve, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik. Mbështetur në nenin 33, germa dh), të ligjit numër 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetime audiovizive", pika 5.1, 5.2, dhe 5.3 për mosrespektimin e të drejtave të të miturve në programet informative, konstatoi se subjekti kishte vepruar në shkelje të tyre.

Më konkretisht, neni 33 i Ligjit 97/2013, përcakton qartë detyrimet e OSHMA-ve, ndër të tjera, "...të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar...".
Gjithashtu, Kodi i Transmetimit, përkatësisht në pikat 1.3, 1.4 dhe 1.17, në seksionin "Parimet Themelore", shprehet qartësisht:

- Transmetimet audovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut'

- Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesatdhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve;

- Transmetimet audiovizive duhet të promovojnë dhe të mbrojnë mirëqenien, shëndetin dhe zhvillimin harmonik moral e fizik të të miturve.Po Kodi i Transmetimit, seksioni 5, "Fëmijët në transmetime audiovizive", detyron operatorët audiovizivë për të mosrespektuar të drejtat e të miturve në programet informative.

AMA vendosi në dijeni Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, se:

-subjektit televiziv i ishte tërhequr më parë vëmendja për mosrespektim të të drejtave të të miturve në transmetimet televizive, shkelje të etikës dhe privatësisë;
-subjekti kishte reflektuar pozitivisht menjëherë pas masës "Tërheqje vëmendje". I fundit rast ishte publikimi i dhunës në kopshtin e fëmijëve "Diren", kur gjatë transmetimeve dhe intervistimeve është treguar kujdes maksimal për të shmangur identifikimin e fëmijëve.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**
**Ministria e Mirëqenies Sociale dheRinisë**

Nr. prot. 212

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Ora News** | **Edicion Informativ** | **19.08.2016** |
| **ABC News** | **Edicion Informativ** | **22.08.2016** |
| **TV Klan** | **Edicion Informativ** | **22.08.2016** |

## 1. Programi

Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionet informative të këtyre subjekteve audiovizive, dy prej të cilave janë televizione informative që transmetojnë edicione informative 24 orë në 24 dhe vetëm një prej tyre është televizion me përmbajtje programore tradicionale. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është publikimi i të dhënave sensitive lidhur me rastin e një fëmije, viktimë e abuzimit seksual në familje.

## 2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Ankesa bazohet edhe në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" neni 33, germa dh) dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audivizive miratuar në 27 janar 2014, seksioni 1 "Parime Themelore", pika 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 ( garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi thekson se nisur nga ngjarja e Dibrës, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve shpreh shqetësimin për mënyrën se si ky rast është raportuar në mediat audiovizive. Ankuesi (Agjencia) pretendon se këto janë vetëm disa nga mediat audiovizive që ata kanë konstatuar, sepse mund të ketë edhe media të tjera që kanë nevojë të monitorohen lidhur me publikimin e lajmit në fjalë. Ankuesi vëren se ka qenë Televizioni Ora News, i cili publikoi lajmin duke dhënë të plotë emrin dhe mbiemrin e babait abuzues, emrin e fshatit dhe rrethit. Gjithashtu, në këtë lajm u publikua edhe foto nga shtëpia e fëmijës viktimë. Ankuesi thekson gjithashtu se, dy ditë më vonë ishte kanali televiziv ABC News, i cili transmetoi të njëjtin lajm duke publikuar në mënyrë të ngjashme detaje të emrit dhe mbiemrit të babait, emrin e fshatit, si dhe foto të shtëpisë. Po atë ditë, TV Klan publikoi lajmin, ku përveç detajeve të sipërpërmendura të publikuara gjithashtu, është transmetuar informacion sensitiv lidhur me veprimin e turpshëm të babait abuzues.

Bazuar sa më sipër ankuesi vë në dukje se publikimi i lajmit mbi abuzimin seksual të fëmijës në familje në mediat e sipërpërmendura, përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu veçanërisht, të drejtën e konfidencialitetit dhe privacisë së fëmijëve. Sipas tij, raportimi i ngjarjes nga këto media bën të mundur identifikimin në mënyrë indirekte të fëmijës viktimë përmes publikimit të detajeve të sipërcituara.
Prandaj ankuesi argumenton se informacione të tilla të bëra publike, që i bën fëmijët të identifikueshëm në rastet kur ato janë viktimë e një ngjarje të rëndë, ndikojnë në riviktimizimin e fëmijës dhe rehabilitimi i tyre më pas bëhet shumëmë i vështirë. Ndaj, ankuesi veçon ndër të tjera që mbrojtja e interesit më të lartë për fëmijën duhet të jetë parimi mbizotërues që duhet të udhëheqë punën e medias para çdo interesi tjetër.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialeve filmike, Këshilli i Ankesave konstatoi se të dy televizionet në të vërtetë e kanë publikuar lajmin, duke dhënë të plotë emrin dhe mbiemrin e babait abuzues, emrin e fshatit dhe të rrethit. Po ashtu, janë publikuar pamje nga shtëpia e fëmijës viktimë. TV Klan transmetoi gjithashtu detaje sensitive lidhur me veprimin e ulët të babait abuzues. Duke iu referuar dëshmisë së dhënë në gjykatë nga njerka e 15-vjeçares, në kronikë përmenden madje edhe shprehje, të cilat nuk duheshin lënë me zë dhe figurë. Ato mund të ishin shmangur në çdo rast për të evituar çdo traumë psikologjike që mund t'i shkaktohet të miturës më pas, kur ngjarja me shumë gjasë publikohet edhe në shtypin e shkruar. Duke rikujtuar se kuadri legjislativ dhe rregullator për mediat audiovizive përcakton qartë përgjegjësitë e mediave ndaj respektimit të të drejtave të fëmijëve, Këshilli i Ankesave kujton se OSHMA-të kanë detyrimin ligjor të ndalojnë transmetimin e programeve që çojnë direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar apo i akuzuar për kryerjen e një vepre penale.
Duke konsideruar Ligjin 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" mbështetur në nenin 33, germa dh) dhe në Kodin e Transmetimit të AMA- s, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1. 17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audivizive", pikat 5.1 dhe 5.2 ku përcaktohet qartësisht se: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale"; dhe se po ashtu "duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë oseështë përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare", Këshilli i Ankesave vendosi të mbështesë ankesën e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

*Në këtë aspekt*:

Këshilli vuri në dukje se tema e abuzimit seksual të të miturve nisur dhe nga përvojat e kaluara në mediat audiovizive të cilat raportojnë detaje të panevojshme dhe sensitive që çojnë në identifikimin e fëmijës direkt apo indirekt të tij, duke cenuar/ shkelur të drejtat e të miturve bazuar në legjislacionin më sipër, ka qenë jo pak herë subjekt i një numri të shumtë ankesash të shqyrtuara nga Këshilli, kohët e fundit. Këshilli i Ankesave gjithashtu vuri në dukje se kjo temë mbetet një çështje sensitive dhe është trajtuar nga Këshilli në debate publike, apo dhe konferenca të organizuara për këtë qëllim. Por kjo, megjithatë nuk do të thotë se sa herë ka ngjarje të tilla të rënda mund të publikohet çdo detaj që përbën të dhëna sensitive pavarësisht interesit të lartë publik. Këshilli mendon se trajtimi i publikimit të këtyre detajeve do të duhej të përcaktohej në varësi të përmbajtjes specifike të një programi të caktuar.

Në këtë kontekst, Këshilli i Ankesave e ka mbështetur ankesën e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, bazuar mbi përmbajtjen dhe argumentimin e saj ligjor, teksa është fokusuar në aspektet e të drejtave të të miturve dhe në veçanti, mbi ndikimin personal që këto publikime të detajuara luajnë me personalitetin psikomotor të fëmijëve më vonë. Që këtej, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive vendosi t'u tërheqë vëmendjen operatorëve audiovizivë si Ora News, ABC News dhe TV Klan mbështetur mbi Ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1 "Parimet themelore", si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pikat 5.1 dhe 5.2 për mosrespektim të të drejtave të të miturve në transmetimet audiovizive.

Ankesa e paraqitur: **Reagime të shumta në rrjetet sociale**

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
| --- | --- | --- |
| **OSHMA-të** | **Edicioni Informativ** | **25.08.2016** |

## 1. Programi

Ankesat i referohen publikimit dhe raportimit në edicionet informative në të gjitha subjektet, për shkelje të Kodit të Transmetimit gjatë raportimit të lajmit për vrasjen e një 12-vjeçari, në fshatin Palasë të Himarës, ngjarje e ndodhur më datë 17/08/2016. Pas kësaj, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori menjëherë në shqyrtim materialet filmike të shfaqura pothuaj nga të gjitha subjektet audiovizive për raportimin e lajmit në fjalë dhe vijimin e tij, përkatësisht në datat 17 dhe 18 gusht 2016.

## 2. Kategoria

Ankesat dhe shqetësimet publike, duke nisur nga shqetësimi i Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Medias dhe Edukimit, z Genc Pollo, ngrihen mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" si dhe kryesisht Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit Nr. 1, datë 27. 01. 2014 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive" (Seksioni 5: pikat 5.1 dhe 5.2).

## 3. Përmbledhja e ankesës

Pas marrjes së ankesave, Këshilli i Ankesave shqyrtoi kronikat televizive gjatë edicioneve informative të përsëritura madje disa herë, në datat 17-18 gusht 2016. Në të gjitha subjektet audiovizive, u evidentuan shkelje të parimeve themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, standardeve profesionale bashkëkohore, shkelje të normave dhe kërkesave morale dhe etike, ku mbështetet Kodi i Transmetimit.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive reagoi me anë të një njoftimi për shtyp duke tërhequr vëmëndjen e të gjithë operatorëve. Njoftimi shpreh shqetësimin se publikimi i këtij lajmi shkel të drejtat e fëmijëve dhe parimeve të sanksionuara në Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 1, datë 27. 01. 2014 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive". Raportimi i hollësishëm i këtyre akteve të rënda në adresë të tyre më shumë se sa flet për ngjarjen, shton dhimbjen që ato lënë pas, duke përbërë kështu dhe shkelje të etikës në gazetari.
Autoriteti risolli në vëmendje se, Kodi i Transmetimit, seksioni 1, pika 1.3 ka për qëllim të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së televizioneve, duke synuar që ato të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në transmetimin e programeve në përputhje me respektimin e lirive etë drejtave themelore të njeriut, me standardetdhe parimet etike e morale të shoqërisë, me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të të miturve, respektimin e privatësisë, dinjitetit, pluralizmit, paanësisë etj.

Pavarësisht përpjekjeve për të zbatuar parimet etike, në rastin e raportimeve mediatike për ngjarjen në Palasë, më datë 17/08/2016, Autoriteti konstatoi se ka patur përsëritje të tepruar të detajeve të sipërcituara, duke cenuar personalitetin dhe dinjitetin e viktimës të të miturit 12-vjeçar.

Në njoftimin për shtyp u theksuan se Këshilli i Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive vendos t'ju risjellë në kujtesë parimet ligjore dhe etike që duhet të ndiqni mbështetur në nenin 33, germa dh), i ligjit numër 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, seksioni 2 "E drejta për Privatësi në Transmetimet Audiovizve" pika 2.8, 2.9, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetime audiovizive", pika 5.1, dhe 5.2 për mosrespektim të të drejtave të të miturve në programet informative.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Ministria e Mirëqenies Sociale dheRinisë**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni Klan** | **Edicioni Informativ** | **27.08.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet publikimit të një video në edicionet informative të Tv Klan, në datën 27 gusht 2016, në të cilën paraqitet një e mitur, që dhunohet në një ambjent publik nga një 30- vjeçar. Sipas ankuesit, kjo video pas shfaqjes në TV Klan është përhapur në të gjitha mediat online. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është ekspozimi i plotë i të miturës dhe i dhunuesit duke e bërë të identifikueshme të miturën në media.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Ankesa i referohet gjithahstu edhe Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit Nr. 1, datë 27. 01. 2014 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive", si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 dhe 5.2 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhje

Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka dërguar një ankesë në adresën zyrtarë të faqes së AMA-s ku bën me dije se në TV Klan është publikuar një video, ku ekspozohet një e mitur, e cila dhunohet në një ambjent publik nga një 30-vjeçar. Ankuesi (Agjencia) konstaton që video e transmetuar në TV Klan ku shfaqet pamja e plotë e vajzës dhe e dhunuesit duke e bërë të identifikueshme vajzën e mitur, është përhapur më pas në të gjitha mediat online.
Në ankesë shprehet shqetësimi se ka pasur dhe raste të tjera të ngjashme të publikuara nga subjektet audiovizive, ku janë cenuar/ prekur të drejtat e të miturve por megjithatë kjo dukuri nuk është ndalur.
Bazuar sa më sipër, ankuesi vë në dukje se publikimi i kësaj ngjarje të rëndë ku një e mitur dhunohet në publik, përbën shkelje të të drejtave të fëmijës, përfshi këtu dhe parime të tjera bazë siç janë garantimi i mbrojtjes së fëmijës dhe e drejta absolute për privatësi. Prandaj ankuesi argumenton se, me gjithë shqetësimet e përsëritura të agjencisë por dhe masat e ndërmarra nga Autoriteti i Medias Audiovizive, ka ende raportime me publikime të tilla të detajeve sensitive nga operatorët audivizivë, që dëmtojnë imazhin dhe integritetin e fëmijëve dhe më të qartë identifikimin e vajzës së mitur.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialeve filmike, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa e ardhur në drejtim të subjektit në fjalë nuk qëndron për disa arsye të argumentuara më poshtë si: në të vërtetë pamjet e ekspozuara në videon amatore janë të paqarta, kjo për shkak edhe të cilësisë së dobët të imazhit të saj. Përveç kësaj edhe distanca nga është filmuar skena është e konsiderueshme, ndaj për këtë arsye është e pamundur të krijohet një ide e qartë mbi situatën në detaje e jo më të flitet për identifikim të personave. Bazuar mbi një monitorim të hollësishëm të planeve të xhiruara, Këshilli i Ankesave nuk mendon se arrihet të identifikohet e mitura po aq dhe autori i dhunës mbi të. Subjekti audioviziv për të cilin po flasim nuk ka përdorur fasho mbrojtëse, ndoshta edhe për shkak se cilësia e videos amatore është shumë e dobët dhe nuk ka qenë e nevojshme.
Këshilli i Ankesave ndoqi me vëmendje edhe tekstin e kronikës, i cili është korrekt. Aty nuk ka identifikim as të drejtëpërdrejtë dhe as të tërthortë të së miturës dhe nuk përmenden as iniciale, e as të dhëna të tjera që mund të çojnë në identifikimin e saj.

*Në këtë aspekt:*

Nisur nga rastet e përsëritura të dhunës ndaj të miturve, si ky i fundit i publikimit të një video në edicionet informative dhe duke marrë parasysh pikat e mësipërme, Këshilli i Ankesave mendon se transmetimi i kësaj ngjarje nga operatori televiziv përbën interes publik dhe ankesa nuk qëndron.
Autoriteti i Mediave Audiovizive ndjek me shqetësim çdo ankesë për cenim/shkelje të Ligjit 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të parimeve dhe rregullave që përmban Kodi i Transmetimit. Dhe më e vëmendshme është ajo sidomos ndaj çështjeve që lidhen me shkeljen etike që i bëhet fëmijëve. AMA u ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen subjekteve audiovizive dhe në raste të tjera ka ushtruar sanksione ndaj OSHMA-vë kur në përmbajtjen e transmetimeve të tyre ka konstatuar cenim të etikës që çon deri në shkeljen e parimeve bazë të legjislacionit shqiptar për mediat audiovizive.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**
**Ministria e Mirëqenies Sociale dheRinisë**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni Klan** | **Edicioni Informativ** | **05.09.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet transmetimit të një lajmi të publikuar në edicionet informative të TV Klan, një televizion me programacion tradicional. Ky lajm u publikua gjatë 5 edicioneve informative të këtij televizioni, në datën 5 shtator. Megjithëse rasti ka ndodhur një vit më parë është rikthyer sërish në vëmendjen e mediave për shkak të procesit gjyqësor të babait abuzues.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", kryesisht Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit Nr. 1, datë 27. 01. 2014 *"Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive"*, seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 dhe 5.2 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhje e Ankesës

Ankuesi ka dërguar një ankesë në adresën zyrtarë të faqes së AMA-s ku bën me dije se në TV Klan është publikuar një kronikë televizive, përmbajtja e së cilës cenon të drejtat e fëmijëve në transmetimet audiovizive. Rasti në fjalë ka të bëjë me publikimin e të dhënave identifikuese të së miturës, e cila dyshohet se është abuzuar nga babai në muajin nëntor të vitit 2015.

Në tekstin e kronikës jepen detajet identifikuese të saj, emri dhe pamja e babait abuzues në sallën e gjyqit, detaje nga seanca gjyqësore si dhe detaje sensitive nga ngjarja e ndodhur një vit më parë.
Ankuesi (Agjencia) konstaton se ky është një rast që ka ndodhur vitin e kaluar, por që këto ditë u kthye në vëmendjen e mediave për shkak të procesit gjyqësor të babait abuzues.
Në ankesë gjithashtu shprehet shqetësimi se raste të abuzimit seksual me fëmijët, për fat të keq, shpesh publikohen nga mediat e shkruara dhe vizive duke publikuar të dhëna që identifikojnë fëmijët në mënyrë direkte apo indirekte.
Bazuar sa më sipër ankuesi vë në dukje se publikimi i të dhënave të mësipërme bën të mundur identifikimin e të miturës për herë të dytë, pas një viti që ka ndodhur ngjarja duke shënuar shkelje të të drejtave të fëmijës dhe parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", për ruajtje të konfidencialitetit dhe të privacisë së fëmijës.
Ankuesi thekson se ripublikimi i ngjarjes, ku viktimë e ngjarjes sërëndë është një e mitur rrezikon sërish në riviktimizimin e fëmijës dhe sipas tij rehabilitimi i tyre bëhet shumë i vështirë më pas. Mbrojtja e interesit më të lartë për fëmijën veçohet në ankesë, duhet të jetë parimi mbizotërues që duhet të udhëheqë punën e medias para çdo interesi tjetër. Agjencia vëren se të dhënat identifikuese dhe detajet e mësipërme dëmtojnë integrimin e së miturës dhe rehabilitimin e saj pas traumës që ka pësuar.

### 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialeve filmike, Këshilli i Ankesave konstatoi se sa i përket përshkrimit të kronikës, është e vërtetë se ajo jep detaje identifikuese të së miturës, emrin dhe pamjen e babait abuzues në sallën e gjyqit, detaje nga seanca e gjyqit si dhe nga ngjarja e rëndë e ndodhur një vit më parë. E vërteta është se këto detaje e bëjnë të miturën të identifikohet lehtë.

*Në këtë aspekt:*

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, vendosi kthimin e përgjigjes ndaj ankuesit bazuar kryesisht edhe nga përgjigjet e rasteve të fundit që janë shënuar mbi cenimin e të drejtave të fëmijëve nga subjektet audiovizive. Këshilli i Ankesave edhe për episode të ngjashme ka pasur qëndrimin e tij të posaçëm ndaj subjekteve audiovizive që kanë shënuar shkelje të Kodit të Transmetimit lidhur me Fëmijët në Transmetimet Audiovizive. Në këtë mënyrë, Këshilli e pa të arsyeshme të përmendë edhe publikimin e një Njoftimi për Shtyp të datës 25 Gusht 2016, ku iu risollën në vëmendje të gjithë operatorëve audiovizivë parimet dhe rregullat mbi garantimin e mbrojtjes së fëmijëve, të drejtën absolute të tyre për privatësi dhe ku i jepet përparësi interesit të lartë të tyre për t'u vendosur në qendër problemit, parime dhe rregulla këto të domosdoshme.

Këshilli i Ankesave shprehet në përgjigjen e tij se është besimplotë në një reflektim më serioz të tyre për të ndjekur me kujdes parimet dhe rregullat e shkruara në Kodin e Transmetimit, pavarësisht se shpesh herë ngjarjet përbëjnë interes publik.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Ministria e Mirëqenies Sociale dheRinisë**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni Klan** | **"E Diela Shqiptare"** | **09.10.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet mënyrës së pasqyrimit në mediat audiovizive, të ngjarjeve ku janë të përshirë fëmijët. Konkretisht, në emisionin "E diela shqiptare", në rubrikën "Ka një mesazh për ty" në TV Klan, datë 09.10.2016.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", kryesisht Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit Nr. 1, datë 27. 01. 2014 *"Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive"* ,seksioni 5, *"Fëmijët në transmetimet audiovizive"*, pika 5.1 dhe 5.2 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhje e Ankesës

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka dërguar një ankesë në adresën zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive *info@ama.gov.al* ku bën me dije se, në emisionin "E Diela Shqiptare" në TV Klan është publikuar rasti i një fëmije 12 vjeç, që kishte përjetuar një histori shfrytëzimi nga tezja e tij. Sipas ankuesit, publikimi konsiderohej një ngjarje e rëndë e sensitive, ku identiteti i fëmijës duhej të mbrohej dhe të mos zbulohej si për fëmijën, ashtu dhe për publikun.Sipas ankesës, rasti është publikuar në ekran me emër dhe mbiemër, me pamje të fëmijës dhe të babait të tij, adresa e shtëpisë, lagjja ku ai banonte, si dhe fëmijët e tjerë të familjes.

Ankuesi shprehet se të gjitha këto përbëjnë mosruajtje të privacisë dhe cenim të dinjitetit dhe moralit të fëmijës, që mund të ketë pasoja për riintegrimin e tij në të ardhmen. Publikimi i historisë së tij, sipas Agjencisë, mund të bëhet shkak për ekspozimin e tij ndaj rrezikut për këtë fëmijë, që më herët ka qenë objekt shfrytëzimi për lypje dhe forma të tjera të trafikimit. Gjithashtu në ankesë ngrihet shqetësimi se fëmija mund të bëhet objekt stigmatizimi nga moshatarët apo të tjerë persona që e kanë identifikuar atë përmes medias.

Në ankesë gjithashtu shprehet shqetësimi se intervistimi i fëmijës dhe prania e tij në emision është bërë pa dijeninë dhe rrjedhimisht pa pëlqimin e një të rrituri, megjithëse edhe po të kishin pëlqimin e tij, kjo nuk mund të jetë një arsye e mjaftueshme për të publikuar rastin në emision. Në ankesë vërehet se publikimi i një historie shfrytëzimi për punë te një fëmijë, në një TV Kombëtar mund të shihet nga publiku i painformuar si promovim i dukurisë në TV. Edhe pse shkarazi u përmend nga fëmija që ai nuk duhet të punojë, nuk u vu theksi nga drejtuesi i emisionit për këtë dukuri të kundërligjshme dhe, sipas Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, cenon të drejtat e fëmijës. Ankuesi shton në fund se nisur nga faktet e sipërcituara kërkohet marrja e masave konkrete për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, gjatë transmetimeve të operatorëve të shërbimeve audiovizive, në përputhje me Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe Vendimin Nr. 1 datë 20. 01. 2004 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive".

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim materialet filmike, dhe konstatoi se sa i përket përshkrimit të kronikës, është e vërtetë se ajo jep detaje identifikuese të së miturës në ekran, emrin, pamjen e babait abuzues në sallën e gjyqit, detaje nga seanca e gjyqit si dhe nga ngjarja e rëndë e ndodhur një vit më parë. E vërteta është se këto detaje e bëjnë të miturën të identifikohet lehtë.

*Në këtë aspekt:*
Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, vendosi kthimin e përgjigjes ndaj ankuesit, bazuar kryesisht edhe nga përgjigjet e rasteve të fundit që janë shënuar mbi cenimin e të drejtave të fëmijëve nga subjektet audiovizive.

Këshilli i Ankesave edhe për episode të ngjashme ka pasur qëndrimin e tij të posaçëm ndaj subjekteve audiovizive që kanë shënuar shkelje të Kodit të Transmetimit lidhur me Fëmijët në Transmetimet Audiovizive. Në këtë mënyrë, Këshilli e pa të arsyeshme të përmendë edhe publikimin e një Njoftimi për Shtyp të datës 25 Gusht 2016 ku u risillen në vëmendje të gjithë operatorëve audiovizivë parimet dhe rregullat mbi garantimin e mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e tyre për privatësi dhe ku i jepet përparësi interesit të lartë të tyre për t'u vendosur në qendër të problemit, parime dhe rregulla këto të domosdoshme.

Ankesa e paraqitur: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**
**Ministria e Mirëqenies Sociale dheRinisë**

Nr. prot. 333 **Dt. 09. 11. 2016**

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni News 24** | **Informativ** | **08.11.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet një kronikë transmetuar në edicionin informativ të News 24, ku jepet intervista e nënës së një vajze 17 vjeçe të përdhunuar nga babai i saj. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ngre shqetësimin se publikimi në media i intervistës së nënës së 17-vjeçares si dhe pamjet e banesës, e identifikojnë të miturën, duke shkelur parimet e mbrojtjes së fëmijëve. Sipas ankuesit, identifikimi i saj bëhet i qartë përmes publikimit të intervistës së nënës së vajzës, e cila është plotësisht e identifikuar me zë dhe figurë duke pretenduar se operatori audioviziv ka publikuar madje edhe emrin e saj.

## 2. Kategoria

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve shpreh shqetësimin se transmetimi ka shkelur parime të saksionuara në konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës", Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë si dhe Kodin e Transmetimit.

## 3. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe vërejti se transmetimi në Televizionin News 24 nuk e identifikoi asnjëherë të miturën dhe, pavarësisht që intervista e nënës mund të çojë në një identifikim të tërthortë, familja e vajzës dhe vetë operatori audioviziv kanë gjykuar se publikimi i historisë do të sensibilizojë institucionet për t'i ofruar siguri familjes në fjalë.

Nisur nga përmbajtja e intervistës, Këshilli i Ankesave vërejti se anëtarët e kësaj familjeje ende nuk ndjejnë siguri nga kryefamiljari i tyre, duke kërkuar në këtë mënyrë më shumë mbështetje nga institucionet për t'u mbrojtur prej babait dhunues në ndjekje, ndaj në këto kushte, publikimi i kësaj ngjarjeje, sipas gjykimit të Këshillit të Ankesave, shërben për të ndihmuar familjen në nevojë.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Duke vlerësuar sërish shqetësimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Këshilli i Ankesave gjykoi se publikimi i kësaj ngjarje përbën interes publik.

Këshilli i Ankesave kujton se Kodi i Transmetimit specifikon se, në rastet kur ngjarja përbën interes publik, ajo mund të transmetohet, madje edhe kur jepen detaje identifikuese të viktimës. Në seksionin nr. 2 të Kodit të Transmetimit, në "E drejta për Privatësi në Transmetimet Audiovizive", pika 2.5 thuhet se "Publikimi i të dhënave personale të individëve të ndryshëm, mund të bëhet vetëm duke mbajtur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, duke ruajtur balancën e interesave individ –publik". Po kështu në seksionin 3 të Kodit të Transmetimit, në "Transmetimet audiovizive dhe interesi publik", pika 3.2, thuhet se "OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh se shkelja e dispozitave të Kodit të Transmetimit mund të përligjet vetëm kur mund të tregohet qartë se kjo është në shërbim të interesit publik".

Sa më sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi se publikimi i intervistës së nënës të të miturës me detajet e sipërpërmendura përbën interes publik dhe si e tillë nuk konsiderohet shkelje e Kodit të Transmetimit.

Në lidhje me parimet bazë të mbrojtjes të të miturve, siç janë garantimi i mbrojtjes dhe e drejta absolute e tyre, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ka paralajmëruar disa herë televizionin News 24, i cili për hir të së vërtetës, ka reflektuar në mënyrë të përgjegjshme ndaj ankesave me të njëjtën tematikë.

Përmes përgjigjes, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve iu bë e ditur se Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) dhe Këshilli i Ankesave pranë tij, vazhdon të ndjekë me përkushtim çdo rast që e gjykon se cenon/shkel të drejtat e të miturve në transmetimet audiovizive.

# 2

# Ankesa me subjekt cënimi i rregullave të etikës

Ankesa e paraqitur: **Nga dy individë.**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
| --- | --- | --- |
| **Televizioni Klan** | **"Zonë e Lirë"** | **20. 04. 2016**<br>**03. 05. 2016** |

## 1. Programi

Programi është një emision me karakter gjeneralist, që mbështetet mbi aktualitete të ndryshme, politike, sociale dhe kulturore, lokale e ndërkombëtare. Ankesat lidhen me bisedën live me dy këngëtaret e ftuara në studio, ku janë përdorur shprehje të papërshtatshme, gjeste dhe performanca që shkelin rëndë etikën dhe normat morale.

## 2. Kategoria

Ankesa bazohet në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, germa d); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audivizive (AMA), miratuar në 27 janar 2014, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.7, seksioni 4, "Transmetimi i programeve informative", pika 4.8, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", nënseksioni "Programet kulturore argëtuese, filmat dhe fëmijët".

## 3. Përmbledhje e ankesës

Nëpërmjet e-mailit të tyre, të dy ankuesit e vendosin theksin tek shkeljet e etikës përmes fjalorit, gjesteve dhe puthjes mes dy këngëtareve. Ata shprehin shqetësimin se nuk ka asnjë përpjekje nga moderatori për të apeluar për largimin e fëmijëve nga ekrani. Në thelb, dy ankuesit ngrenë shqetësimin e shkeljes së rregullave të etikës në transmetimet televizive.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së dy ankesave për shkelje flagrante që, në thelb, ngrenë shqetësimin e shkeljes së rregullave të etikës në transmetimet televizive, Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim emisionin në fjalë, duke iu referuar pjesës nga ora 21: 05- 22: 30.

Gjatë kësaj pjese u evidentuan shkelje gjatë bisedës mes dy të ftuarave dhe moderatorit. Konkretisht, janë përdorur shprehje të papërshtatshme, gjeste dhe performanca që shkelin etikën, të palejueshme për orarin e transmetimit.

Pavarësisht vendosjes së shenjës paralajmëruese (-16), gjatë emisionit mungonte kërkesa e drejtpërdrejtë dhe e përsëritur e moderatorit për largimin e fëmijëve nga ekrani. Madje, pati kërkesa të vazhdueshme për përsëritje të skenave dhe gjesteve të papërshtatshme.

Neni 33 i Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" përcakton qartë detyrimet e OSHMA-ve (Ofruesve të Shërbimit Madiat Audioviziv). Në pikën d) të këtij neni thuhet shprehimisht: (OSHMA-të) duhet të "respektojnë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojnë programe që mund të nxisin vepra penale".

Edhe Kodi i Transmetimit i Autoritetit të Mediave Audivizive (AMA), miratuar në 27 janar 2014, në seksionin "Parime Themelore", pikat 1.4, 1.7 dhe 1.14 përcaktojnë gjegjësisht: "Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve."; "Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë, sidhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit"; "Transmetimet audiovizive që përmbajnë elemente të pornografisë apo dhunës sëskajshme duhet t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të kriptuara". Po ashtu, seksioni 4 dhe 5, i Kodit të Transmetimit, "Transmetimi i programeve informative" dhe "Fëmijët në transmetimet audiovizive", përcaktojnë qartë detyrimet për OSHMA-të.

Ritransmetimi i emisionit, në datë 30 Prill 2016, nga ora 11:11, si dhe përfshirja e një kronike informative në edicionet e lajmeve në televizionin kombëtar "Klan" mbi performancën e dy të ftuarave në emisionin "Zonë e Lirë", u gjet në shkelje të plotë të Kodit të Transmetimit.

Ndaj, bazuar për sa më sipër dhe mbështetur në nenin 33, pika 1, gërma (d) dhe (e) të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parime themelore", Seksioni 4, "Transmetimi i programeve informative" pika 4.8, "Seksioni 5, "Programet kulturore argëtuese, filmat dhe fëmijët", si dhe në zbatim të nenit 133, pika 1, germa a) dhe duke pasur parasysh kohën kur programi është emetuar në një televizion me licencë kombëtare e me impakt në publik, AMA i ka tërhequr vëmendjen televizionit Klan për të mos përsëritur raste të tilla, që bien ndesh me ligjin dhe Kodin e Transmetimit, në të kundërt, Autoriteti do të ndjekë procedurat për sanksion në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Ankesa e paraqitur: **Znj. E.M.**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Televizioni Klan** | **"E diela shqiptare"**<br>**"Shihemi në gjyq"** | **21. 04. 2016** |

## 1. Programi

Programi është një spektakël i përjavshëm prej disa orësh, ku përfshihen informacione dhe lojëra të ndryshme argëtuese, biseda dhe intervista. Ndërsa rubrika "Shihemi në gjyq", e përfshirë brenda këtij programi, synon pajtimin e personave ose palëve të përfshira në konflikte të ndryshme, në përpjekje për të shmangur përballjen gjyqësore. Ankesa lidhet pikërish me një përballje të tillë gjyqësore, ku një palë ka refuzuar të marrë pjesë, megjithatë, ankuesja pretendon se, gjatë rubrikës i janë cenuar të drejta të jetës private dhe dinjiteti i saj.

## 2. Kategoria

Ankesa bazohet në Ligjin 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 33, germa ç), d) dhe dh), nenin 46, pika 2, germa b) dhe ç), si dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3. ku përcaktohen qartë detyrimet e OSHMA-ve, që lidhen me trajtimin e ngjarjeve në mënyrë të drejtë, të vërtetë dhe të paanshme për gjitha subjektet e interesuara të përfshira në një çështje të caktuar, të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar.

## 3. Përmbledhje e ankesës

Në Këshillin e Ankesave ka mbërritur një ankesë nga znj. E.M., e cila pretendon se, në programin e datës 17 prill 2016, janë inskenuar skena artificiale, duke shkelur në mënyrë të turpshme dinjitetin e saj, të fëmijëve, të familjes dhe të bashkëshortit të saj.

Ankuesja pretendon se, u ka bërë të ditur drejtuesve të Televizionit refuzimin për të ndërmjetësuar dhe për t'u përmendur në çfarëdolloj mënyre, direkt apo indirekt.

Ajo shkruan në një letër, dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Këshillit të Ankesave në veçanti se: "I jam drejtuar Televizionit Klan, përfaqësuesit ligjor z. Aleksandër Frangaj, sipas Lajmërim Marrjes nr. RR 120489206AA, të datës 01. 03. 2016, ku i kam shprehur refuzim ndërmjetësimi për t'u përmendur në çfarëdo lloj përmase, direkt apo indirekt, në asnjë media vizive apo të shkruar". Sipas saj, televizioni në fjalë ka përbaltur integritetin e një familjeje, konkretisht të familjes së saj, dhe "ka bërë teatër me një temë shumë të ndjeshme në lidhje me moralin, në një qytet shumë të vogël e me tradita si Përmeti".

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Bazuar në ankesën e znj. E. M., me shkresë zyrtare, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ia përcolli këtë shqetësim operatorit televiziv.

Këshilli i Ankesave konstatoi se, për rastin në fjalë, nuk janë përmbushur kërkesat ligjore mbështetur në Ligjin 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", që parashikojnë se: "Çdo person, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim, ka të drejtën e përgjigjes"; si dhe "Personi që ushtron të drejtën e përgjigjes, në përputhje me rregulloren, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit përgjegjës të shërbimit mediatik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij".

Nisur nga kjo, Këshilli i Ankesave, në të njëjtën kohë, ka patur parasysh edhe faktin se transmetimi i kësaj përmbajtjeje është bërë në një televizion kombëtar me impakt tek publiku i gjerë. Nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, vendosi se, duke qenë që cenimi i dinjitetit, personalitetit, privatësisë së individit në një transmetim audioviziv përbën një shkelje të rëndë ligjore, si dhe duke u mbështetur në nenin 33, germa ç), d) dhe dh), nenin 46, pika 2, germa b), c) dhe ç) të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", në Kodin e Transmetimit të AMA-s, si dhe në zbatim të nenit 133, pika 1, germa a), AMA sanksionoi gjobën prej 200. 000 (dyqind mijë) lekësh ndaj operatorit televiziv Klan.

Gjithashtu Autoriteti, i kërkoi operatorit televiziv heqjen e videos përkatëse nga kanali zyrtar në Youtube.

## 5. Trajtimi pas vendimit

Pas protestës së Televizionit Klan, Bordi i AMA-s i kërkoi Këshillit të Ankesave një relacion për çështjen në fjalë. Këshilli i Akesave, bazuar mbi këtë kërkesë, dërgoi relacionin, duke evidentuar shkeljet e konstatuara gjatë shqyrtimit të materialit filmik.

Këshilli i Ankesave i paraqiti Bordit një përmbledhje të ankesës së znj. E.M. ndaj emisionit "E diela shqiptare" dhe pikërisht në rubrikën "Shihemi në gjyq", transmetuar në Televizionin "Klan" në datën 17.04.2016.
Këshilli Ankesave nënvizoi se, pas shqyrtimit të videos përkatëse të emisionit evidentoi shkelje të ligjit dhe Kodit të Transmetimit, duke i cenuar privatësinë, dinjitetin dhe personalitetin ankueses, ku pavarësisht se gjatë emisionit emri i saj nuk u përmend, ajo u identifikua në mënyrë të tërthortë, duke dhënë indicie jo të pakta mbi identifikimin e saj (ankueses), E.M.

Këshilli i Ankesave gjeti shkelje të neni 33 të ligjit nr 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", konkretisht pikat ç), d) dhe dh) që evidentojnë:

Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet:

ç) të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;

d) të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale;

dh) të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe.

Kodi i Transmetimi përcakton në pikën 2.1 se "OSHMA-të, në veprimtarinë e tyre audiovizive, duhet të respektojnë parimin se e drejta për lirinë e shprehjes nuk duhet të tejkalohet deri sa të cenojë të drejtën e individit për të mbrojtur privatësinë, të dhënat e tij personale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kjo është një e drejtë themelore e njeriut, e përcaktuar në Kushtetutën e Shqipërisë".

Ankesa e paraqitur: **Nga L.B.**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **Tv Rozafa** | **Programacion** | **28 - 29. 06. 2016** |

## 1. Programi

Ankesa e ardhur pranë adresës elektronikë të Autoritetit të Mediave Audiovizive nga një shikues shprehej se në datën 24. 06. 2016, subjekti ka transmetuar në orar të papërshtatshëm disa skena të rënda erotike në përmbajtjen e një filmi artistik shfaqur në TV Rozafa.

## 2. Kategoria

Ankesa i referohet një filmi me skena deri në kufijtë e pornografisë shfaqur nga TV Rozafa në një orar krejt të papërshtatshëm dhe respektivisht në orën 13:00. Ajo gjen bazë në Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" si dhe kryesisht Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit Nr. 1, datë 27. 01. 2014 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive", (Seksioni 5).

## 3. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi materialet e transmetuara nga operatori Tv Rozafa, përgjatë 24 orëve (00.00 - 23.59), në datat 28 -29 Qershor 2016 dhe me shqetësim konstatoi shkelje të Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Konkretisht Kodi i Transmetimit, seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive" pika 5.28, thuhet se "OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të të miturve, në veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale", dhe pika 5.30 e Kodit përcakton se: "OSHMA-të janë të detyruara të vendosin shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht në filmat dhe programet me përmbajtje e skena problematike".

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Duke vlerësuar sërish shqetësimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Këshilli i Ankesave gjykoi se publikimi i kësaj ngjarje përbën interes publik.
Këshilli i Ankesave kujton se Kodi i Transmetimit specifikon se, në rastet kur ngjarja përbën interes publik, ajo mund të transmetohet, madje edhe kur jepen detaje identifikuese të viktimës. Në seksionin nr. 2 të Kodit të Transmetimit, në "E drejta për Privatësi në Transmetimet Audiovizive", pika 2.5 thuhet se "Publikimi i të dhënave personale të individëve të ndryshëm, mund të bëhet vetëm duke mbajtur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, duke ruajtur balancën e interesave individ –publik". Po kështu në seksionin 3 të Kodit të Transmetimit, në "Transmetimet audiovizive dhe interesi publik", pika 3.2, thuhet se "OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh se shkelja e dispozitave të Kodit të Transmetimit mund të përligjet vetëm kur mund të tregohet qartë se kjo është në shërbim të interesit publik".

Ankesa e paraqitur nga: **Nga Individ**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Data | Programi | Subjekti audioviziv |
|---|---|---|
| **20.11.2016** | **Muzikor** | **Televizioni BBF** |

### 1. Programi

Ankesa ngrihet mbi përmbajtjen e disa teksteve të këngëve që transmetohen gjatë ditës në stacionet muzikore shqiptare dhe veçanërisht BBF.

### 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve dhe rregullave të transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1. 14 dhe seksioni 9 Këshilli i Ankesave, pika 9.3, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

### 3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi ka dërguar një ankesë në adresën zyrtarë të faqes së AMA-s, *info@ama.gov.al* ku bën me dije se në Televizionin muzikor BBF është shfaqur një video kënge, përmbajtja e të cilës shkel normat morale dhe etike të Kodit të Transmetimit. Ankuesi shkruan se ndihet i skandalizuar para shfaqjes së disa shprehjeve të rënda erotike gjatë tekstit të këngës, që transmetohen në një orar krejt të papërshtatshëm për mjediset familjare. Ai pretendon se transmetimi i këtyre teksteve të këngëve me përmbajtje skenash të tilla shkel rëndë normat morale dhe etike të shoqërisë shqiptare.

### 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi ankesën më sipër si dhe videon e transmetuar në kanalin muzikor BBF. Në mbledhjen e tij ai i dha të drejtë ankuesit mbi përmbajtjen e teksteve të këngës dhe ky mbetet një shqetësim si pjesë e punës së Këshillit të Ankesave për të monituar zbatimin e ligjit dhe në veçanti të Kodit të Transmetimit.
Në lidhje me videoklipet, nuk ka klauzolë të veçantë, por Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive detyron OSHMA-të që, çdo transmetim i tyre, çdo program i tyre, dhe këtu përfshihen edhe videot muzikore, të jenë në përputhje me Ligjin, me Kodin dhe të respektojnë normat morale dhe etike.
Nga sa më sipër Këshilli i Ankesave vëzhgoi se:
Në Kodin e Transmetimit, pika 1.14 thuhet se "Transmetimet audiovizive që përmbajnë elemente të pornografisë apo dhunës së skajshme duhet t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të kriptuara".
Gjithashtu në pikën 5.28 thuhet se "OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të të miturve, në veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale".
Aktualisht kanë munguar kushtet për akses të kushtëzuar apo për kriptimin e këtyre kanaleve. Me përfundimin e procesit të digjitalizimit do të krijohet mundësia teknike për kontroll prindëror dhe akses të kushtësuar të këtyre programeve.
Njëkohësisht, Autoriteti i Medias Audiovizive si dhe Këshilli i Ankesave do të hartojë rregullat përkatëse, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit, që transmetimi i çdo materiali video muzikore me skena apo fjalor të papërshtatshëm të kenë akses të kushtëzuar në transmetimet audiovizive.

Ankesa e paraqitur: **Nga Individ**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
| --- | --- | --- |
| **Fashion Tv (RTSH)** | **Modë** | **18.12.2016** |

## 1. Programi

Ankesa ngrihet mbi përmbajtjen e programacionit të Fashion Tv të vendosur në kanalet e shtuara të RTSH-së. Aty shfaqen klipe të modeleve në një veshje ekstravagante dhe sipas ankuesit nuk ka asnjë nivel sigurie për katëgoritë shoqërore.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve dhe rregullave të transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1. 14 dhe seksioni 9 Këshilli i Ankesave, pika 9.3, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

## 3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi ka dërguar një ankesë në adresën zyrtarë të faqes së AMA-s, info@ama.gov.al ku bën me dije se në përmbajtjen e klipeve të Fashion Tv ka probleme të shkeljes së normave etike për shoqërinë shqiptare. Ai pretendon se transmetimi i këtyre klipeve me modelet veshur në mënyrë ekstravagante shkel rëndë normat morale dhe etike të shoqërisë shqiptare.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi ankesën më sipër si dhe përmbajtjen e këtij kanali në fashën e orarit për të cilën vjen ankesa. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) sqaron si më poshtë:

Ligji 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodi i Transmetimit përcaktojnë qartësisht limitet për transmetimet audiovizive. Më konkretisht, Kodi i Transmetimit, Seksioni 5 "Fëmijët në transmetime audiovizive", në pikën 5.32 përcaktohet: OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime.(Ora kufi 21.00 –06.00).

Më tej, në pikën 5.33, përcaktohet: Kur programe me përmbajtje që mund të dëmtojë fëmijët transmetohen në formë të hapur ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose të identifikohen nga prezenca e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre. Pra, në këtë rast, subjekti audioviziv, brenda orarit të përcaktuar në pikën 5.32 të Kodit të Transmetimit, duhet të vendosë shenjat përkatëse, sikurse e kërkon ligji.

*Sa më sipër:*
Këshilli i Ankesave po e ndjek këtë çështje, dhe në rast se ka shkelje të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit pritet të marrë masat përkatëse ndaj OSHMA-së.

# 3

# Ankesa të tjera

Ankesa e paraqitur nga: **Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit**

Nr. prot. 156/1

| Data | Programi | Subjekti audioviziv |
|---|---|---|
| **31.05.2016** | **Transmetimet audiovizive** | **OSHMA-të** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet kërkesës së kompanisë Albatrade Plus, dërguar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kompania "Albatrade Plus" ankohet për cenimin që po u bëhet veprave muzikore që ajo përfaqëson nga subjekte operatore të Shërbimit Audiovizual (Radio dhe Televizione).

## 2. Kategoria

Kontrolli i Lartë i Shtetit shpreh shqetësimin e kompanisë Albatrade Plus, sipas së cilës janë rreth 150 subjekte në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë që shkelin ligjin "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", konkretisht nenin 32 "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive", në të cilin thuhet: "OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave".

## 3. Përmbledhja e ankesës

Në përmbushje të objektivave dhe funksioneve të njohura nga ligji si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive si dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka vendosur të ndjekë një politikë të hapur komunikimi dhe bashkëpunimi të pandërprerë me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e të drejtës së transmetimit dhe të drejtës së autorit.

Ndaj AMA ka zhvilluar një sërë takimesh me subjektet mbajtës të të drejtave të distribucionit dhe përfaqësimit, ku në mënyrë të vazhdueshme ju ka kërkuar vënien në dispozicion dhe pranë këtij institucioni të kontratave apo marrëveshjeve lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, për të cilat këto subjekte gëzojnë mbrojtje ligjore, dhe në mënyrë të veçantë identifikimin e shkeljeve konkrete dhe mënyrës së marrjes së masave administrative ndaj tyre.

### 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, referuar ankesës së Kompanisë Albatrade Plus, më të cilën është njohur edhe Këshilli i Ankesave, AMA dërgoi shkresën nr. 1561/1, datë 31/05/2016, përmes së cilës është dhënë një përgjigje e plotë dhe e argumentuar.

Po ashtu, AMA, duke u mbështetur në ankesat e paraqitura nga subjektet ofrues të shërbimeve audio dhe/ose audiovizive, ka marrë dijeni se një pjesë e madhe e këtyre subjekteve janë proceduar në rrugë administrative nga Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit (ZSHDA) dhe ndaj tyre janë vendosur sanksione me gjobë.
Për këto subjekte, AMA ka kërkuar në mënyrë zyrtare nga ZSHDA vënien në dispozicion të informacionit përkatës, me qëllim shmangien e procedimit administrativ për të njëjtën shkelje.

Këshilli i Ankesave mbikëqyr zbatimin e Kodit të Transmetimit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, për çdo subjekt veprimtaria e të cilit rregullohet nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Objekti i punës së Këshillit të ankesave përfshin sidomos respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve, (AlbAutor)**

Nr. prot. 2619

| Data | Programi | Subjekti audioviziv |
|---|---|---|
| **07.09.2016** | **E Drejta e Autorit** | **OSHMA-të** |

## 1. Programi

Shkresa i referohet mosrespektimit të parashikimeve ligjore për të drejtat e autorit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

## 2. Kategoria

Bazuar në ligjin nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" si dhe aktet nënligjore në dhe për zbatim të tij, AMA sjell në vëmendje se çdo ofrues i shërbimeve mediatike audiovizive, përpos respektimit të kushteve dhe kritereve të licensës/ autorizimit, si dhe respektimit të parashikimeve ligjore për të drejtat e transmetimit, ka dhe detyrimin për të respektuar përcaktimet dhe parashikimet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera mbështetëse të lidhura me to. Për dijeni kjo shkresë i është dorëzuar edhe Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit.

## 3. Përmbledhja e ankesës

Në vijim të shkresave nr. 32, datë 30. 08. 2016 deri tek shkresa nr. 160, datë 30. 08. 2016 (sipas renditjes bashkëngjitur në dosje të Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve (ALBAUTOR), me lëndë Ankesa për disa subjekte televizive, dhe duke pasur parasysh se subjekti i përcjellë me shkresat e sipërcituara i përket Drejtorisë së Mbikëqyrjes, Këshilli i Ankesave vlerëson që shkresat të kalojnë pranë kësaj Drejtorie për trajtim të mëtejshëm.distribucionit dhe përfaqësimit ka vështirësuar veprimtarinë e AMA-s në lidhjeme identifikimin e shkeljeve konkrete të pretenduara se janë kryer nga subjekte audio dhe/ose audiovizive.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Në vijim të shkresave nr. 32, datë 30. 08. 2016 deri tek shkresa nr. 160, datë 30. 08. 2016 (sipas renditjes bashkëngjitur në dosje të Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve (ALBAUTOR), me lëndë Ankesa për disa subjekte televizive, dhe duke pasur parasysh se subjekti i përcjellë me shkresat e sipërcituara i përket Drejtorisë së Mbikëqyrjes, Këshilli i Ankesave vlerëson që shkresat të kalojnë pranë kësaj Drejtorie për trajtim të mëtejshëm.

Ankesa e paraqitur: **Dhoma e Avokatisë Durrës/ Av. M. M.**

Nr. prot. 3739

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **OSHMA-të** | **Emisionet informative** | **12.12.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet mënyrës së pasqyrimit në mediat audiovizive, të ngjarjeve të rënda ku janë përshirë fëmijët dhe publikimi i të dhënave të tyre personale. Konkretisht ngjarja e rëndë e Palasës.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", kryesisht Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve si Ligji nr. 10296/ 2010.

## 3. Përmbledhja e ankesës

Në Këshillin e Ankesave ka mbërritur një ankesë nga av. M. M., i cili në bazë të një prokure me nr. 2091/ 1043 dt. 22. 09. 2016 është ngarkuar të përfaqësoj shtetasin P. Zariu në drejtim të interesave ligjore e morale, lidhur me fatkeqësinë e vrasjes së djalit të tyre A. Z. në ngjarjen e publikuar si "..vrasja e monstrës së Palasës, Jorgo Zani..". Nisur nga shqetësimi i familjarëve e sidomos të gjendjes tejet kritike shëndetsore të nënës së fëmijës në shkresë theksohet se me fuqinë që jep ligji Autoriteti i Medias Audiovizive duhet të veprojë të ndalin këto publikime të dëmshme për individin apo dhe familjarët e viktimës. Aty thuhet se përpos situatës tejet të agravuar në kohë e ngjarje, për efekte komercializmi këto kronika janë hedhur edhe në youtube për të bërë sa më të klikueshme këto kanale të tyre në youtube.
Në shkresë kërkohet të ndërhyhet nga ana e AMA-s për të mundësuar heqjen e qarkullimit të informacioneve të ruajtura në sistem të distribuuar nga agjencitë e ndryshme informative. Kjo për shkak edhe të situatës psikologjike të familjarëve të viktimës.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Medias Audiovizive mori në shqyrtim letrën e dërguar nga av. M.M.,në lidhje me informacionet e mbetura në faqet e mediave në internet mbi rastin e vrasjes të të miturit në fshatin Palasë. Avokati ka ngritur nëpërmjet kësaj shkrese shqetësimin e raportimeve të subjekteve audiovizive që ndodhen ende të publikuara në internet.
Këshilli i Ankesave e vlerëson të drejtë shqetësimin e avokatit, por shpreh moskompetencën në lidhje me këtë ankesë, pasi veprimtaria e AMA-s nuk shtrihet në përmbatjen e programeve në internet. Në lidhje me kërkesën, Këshilli i Ankesave sygjeron që pala e interesuar t'u drejtohet subjekteve audiovizive për të hequr nga faqet e tyre online raportimet e detajuara për ngjarjen e rëndë në Palasë, duke u kërkuar heqjen e informacioneve të mbetura nga raportimi i ngjarjes ku përmbahen të dhëna personale të cilat janë tepër sensitive për familjen e viktimës.
Kjo kërkesë duhet të mbështetetet në direktivën europiane, e cila njihet si "E drejta për të harruar" dhe mund ta aksesoni në këtë link;

*http://ec.europa.eu/justice/data-protection/files/factsheets/factsheet_data_protection_en.pdf*

Sipas vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Maj të vitit 2014, subjektet audiovizive mund të jenë të detyruara të fshijnë në faqet e internetit të dhënat e ndjeshme personale, kur rezultatet e kërkimit janë shumë të vjetra dhe nuk janë më të rëndësishme për momentin. Një e drejtë e tillë buron nga direktivat e mbrojtjes së të dhënave të BE.Rikujtojmë se për rastin konkret, Autoriteti i Mediave Audiovizive reagoi me anë të një njoftimi për shtyp duke tërhequr vëmëndjen e të gjithë operatorëve.

Reagimi shprehu shqetësimin se publikimi i këtij lajmi shkel të drejtat e fëmijëve dhe parimeve të sanksionuara në Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 1, datë 27. 01. 2014 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive".

Raportimi i hollësishëm i këtyre akteve të rënda në adresë të tyre më shumë sesa flet për ngjarjen, shton dhimbjen që ato lënë pas duke përbërë kështu dhe shkelje të etikës në gazetari.

Autoriteti risolli në vëmendje se, Kodi i Transmetimit, seksioni 1, pika 1.3 ka për qëllim të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së televizioneve, duke synuar që ato të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në transmetimin e programeve në përputhje me respektimin e lirive e të drejtave themelore të njeriut, me standardet dhe parimet etike e morale të shoqërisë, me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të të miturve, respektimin e privatësisë, dinjitetit, pluralizmit, paanësisë etj.

Në njoftimin për shtyp u theksua gjithashtu se "Këshilli i Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive vendos t'ju risjellë në kujtesë parimet ligjore dhe etike që duhet të ndiqni mbështetur në nenin 33, germa dh), i ligjit numër 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, seksioni 2 "E drejta për Privatësi në Transmetimet Audiovizve" pika 2.8, 2.9, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetime audiovizive", pika 5.1, dhe 5.2 për mosrespektim të të drejtave të të miturve në programet informative".

# 4

# Letra të hapura

Letër e hapur nga: **Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri**

Nr. prot. 3041

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **OSHMA-të** | **Emisionet informative** | **07.10.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet publikimit të lajmeve mbi ngjarjet ku janë përfshirë fëmijët viktima. Nisur nga rastet e fundit të abuzimeve me të mitur në ankesë theksohet shqetësimi mbi mënyrën abuzive të raportimit të këtyre rasteve në media, duke çuar në identifikimin e viktimave dhe në riviktimizimin e tyre.

## 2. Kategoria

Në përmbajtjen e letrës së hapur nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive ngrihet shqetësimii zbatimit të parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe neneve dhe akteve të Ligjit Nr. 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", për ruajtjen e të dhënave personale, privatësisë dhe konfidencialitetit. Krahas kësaj këto transmetime bien ndesh me standartet dhe praktikat e transmetimeve audiovizive ku një nder parimet bazë është respektimi i privatësisë, e drejta e personit për mosdiskriminim, për konfidencialitet vetjak e familjar bazuar mbi Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit Nr. 1, datë 27. 01. 2014 *"Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive"*, seksioni 5, *"Fëmijët në transmetimet audiovizive"*, pika 5.1 dhe 5.2 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhja e ankesës

Organizata joqeveritare "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" ka dërguar një letër të hapur në Autoritetin e Mediave Audiovizive ku në thelb të përmbajtjes së saj kërkohet zbatimi i parimeve tëKodit të Transmetimit nga operatorët audiovizivë. Fillimisht që në krye të letrës shkruhet se "Rrjeti i Fuqizimit të Grave në Shqipëri", i cili ka ofruar gjithmonë mbrojtje ligjore, këshillim apo integrim në shoqëri ndihet tepër i shqetësuar me publikimin e lajmeve mbi ngjarjet ku janë përfshirë fëmijët viktima. Sipas letrës, nisur nga rastet e fundit të abuzimeve me të mitur, "Rrjeti" ndan shqetësimin për mënyrën abuzive të raportimit të këtyre rasteve në media, duke çuar në identifikimin e viktimave dhe në riviktimizimin e tyre.Në letër theksohet me forcë fakti se publikimi i të dhënave sensitive në mediat audiovizive por dhe portalet online për hir të audiencës, përbën shkelje të parimeve etike që garantohen në legjislacionin shqiptar.Bazuar në pikën 5.1 të Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në të cilën thuhet se: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale", "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri", i dënon ashpër transmetime të tilla televizive dhe kërkon nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) respektimin e parimeve etike prej transmetuesve audiovizivë në përmbajtjen e programeve me subjekt të miturit dhe gratë e dhunuara. Në letër gjithashtu kërkohet bashkëpunim bipartizan nga AMA si aktorë të fuqishëm në sektorin e medias për të parandaluar raste të abuzimit me fëmijët por dhe rastet e dhunës me bazë gjinore. Së fundi, në letër sugjerohet gjithashtu hartimi i disa amendimeve në ligj, për marrjen e masave shtrënguese ligjore në rastet kur media bëhet promotore e dhunës duke u kthyer në një mjet kërcënues me karakter sensacional. Letra i është dërguar për dijeni Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetsinë dhe Nënkomisionit për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore, Dhunës në Familje në Kuvendin e Shqipërisë, Avokatit të Popullit, Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe disa organizatave të gazetarëve shqiptarë.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit me kujdes të letrës, dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive nga "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" mbi zbatimin e Kodit të Transmetimit në lidhje me publikimin e lajmeve mbi ngjarjet ku janë të përfshira gratë dhe fëmijët viktima, Këshilli i Ankesave vendosi t'i përgjigjet letrës duke e konstatuar se shqetësimi që kjo organizatë ngre është tërësisht i drejtë dhe i bashkohet vullnetit të mirë të saj në mbrojtje të kauzës. Por gjithashtu, Këshilli i Ankesave e pa të nevojshme të njohë me anë të kësaj letre organizatën por dhe të gjitha institucioneve që ajo u është drejtuar lidhur me aktivitetin e përditshëm të asaj sa i përket shqetësimeve që ngrihen.Në përgjigjen që i është dërguar letrës thuhet se "AMA dhe Këshilli i Ankesave pranë saj prej muajsh ka marrë rregullisht ankesa nga qytetarë por dhe agjenci e organizata që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, sa i përket cenimit të parimeve themelore dhe rregullave etike që janë vërejtur gjatë transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë në raportimin e lajmeve në shumë OSHMA, që kanë pasur për subjekt gratë dhe të miturit". Në letër shkohet më tej, madje duke shpjeguar se vërtet, Këshilli i Ankesave pranon se raste të abuzimit seksual apo dhunues mbi gratë dhe fëmijët, për fat të keq janë transmetuar nga subjektet audiovizive por më së shumti ato janë publikuar nga mediat e shkruara dhe ato online, të cilat japin të dhëna personale duke identifikuar fëmijët në mënyrë direkte dhe indirekte. Në këtë aspekt në përgjigjen e dërguar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s theksohet qartazi se:

- Këshilli i Ankesave ka konstatuar duke i vëzhguar seriozisht shkeljet e këtyre parimeve nisur dhe nga sensibilizimi i lartë që këto ngjarje kanë pasur. Këshilli ka trajtuar në koherencë të plotë çdo rast të ardhur pranë AMA-s, duke marrë masat përkatëse bazuar mbi ligjin për transmetimet audiovizive.
- Pranë të gjitha subjekteve audiovizive janë dërguar në të gjitha rastet shkresa paralajmëruese dhe ndërgjegjësuese për transmetimin e disa lajmeve, ku preken të drejtat e të miturve, si rasti i abuzimit të një të miture në një familje në Dibër, rasti i vrasjes së një të mituri në fshatin Palasë, përdhunimi i një të miture nga njerku i saj në Fier si dhe rasti i një të miture, e cila dhunohet në publik nga një 30-vjeçar.
- Gjithashtu, në datën 25 gusht 2016, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka dalë madje dhe në një Njoftim Publik me lëndën: "Kujtesë mbi mbrojtjen e të drejtave të të miturve", ku ka vërejtur se shkel të drejtat e fëmijëve dhe parimeve të sanksionuara në Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 1, datë 27. 01. 2014 "Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive".
- Në përgjigjen dërguar 'Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri', AMA u ka rikujtuar gjithashtu subjekteve përmbajtjen e Kodit të Transmetimit me parimet themelore të tij për çdo rast të shoqëruar, duke i paralajmëruar të gjithë transmetuesit audiovizivë se çdo shkelje e Kodit të Transmetimit në rast përsëritje shkeljesh do të shoqërohet me masa ligjore nga ana e Autoritetit.
- Në letër shkruhet më tej se AMA nëpërmjet proceseve të informimit, koordinimit dhe edukimit të tregut në bashkëpunim me aktorët e tjerë synon të nxisë realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri dhe që është i përgjegjshëm për nevojat e shikuesve duke siguruar shumëllojshmëri dhe cilësi të lartë të programeve, sidomos sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Sepse mbrojtja e të miturve në ekran mbetet një nga temat më të rëndësishme në performancën profesionale të subjekteve audiovizive. Aty njoftohet gjithashtu se AMA ka bashkëpunim të vazhdueshëm me disa institucione si Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, Insituti Shqiptar i Medias etj., me disa projekte bashkëpunuese që kanë vijuar dhe po vijojnë gjatë vitit 2016, pikërisht për çështje që lidhen me raportimin e lajmeve me subjekt gratë dhe të miturit, si p.sh. një cikël trajnimesh për performancën e gazetarëve në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Medias në Tiranë, me gazetarë të mediave audiovizive në pesë qarqe të vendit, si Elbasan, Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër me synimin e përmirësimit e raportimit për të drejtat e fëmijëve, nga ku pritet një angazhim në realizimin e një praktike intensive në gazetarinë radiotelevizive, si një mundësi për gazetarët e rinj të fushës që të jenë më familjarë dhe profesionalë në shkrimin dhe transmetimin e lajmeve në respekt të lirive dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të të miturve por dhe barazinë gjinore, shmangien e diskriminimit të çdo forme, respektimin e grupeve minore etj. E së fundi në përgjigjen dërguar 'Rrjetit', AMA e falenderon atë për shqetësimet e ngritura dhe e fton të denoncojë çdo rast specifik ku shkelen të drejtat e çdo qytetari në transmetimet audiovizive.

Letër - propozim: **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**
**Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë**

Nr. prot. 929/1

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
|---|---|---|
| **OSHMA-të** | **Emisionet informative** | **04.11.2016** |

## 1. Programi

Letra bazohet mbi mbërritjen në zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të një letre të hapur nga Rrjeti i Organizatave në Mbrojtje të fëmijëve dhe Grave me lëndë: "Organizatat që mbrojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve, kërkojnë zbatimin e Kodit të Transmetimeve Audiovizive në lidhje me publikimin e lajmeve mbi ngjarjet ku janë përfshirë gratë dhe fëmijët viktima". Aty ndahet shqetësimi i publikimit të ngjarjeve në subjektet audiovizive ku përfshihen fëmijët viktima.

## 2. Kategoria

Shkresa bazohet mbi parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Njeriut". Gjithashtu, shkresa bazohet në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" neni 33, germa dh); dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audivizive miratuar në 27 janar 2014, seksioni 1 "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

## 3. Përmbledhja e letrës

Letra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e cila merr shkas nga një Letër e Hapur e Rrjetit të Organizatave në Mbrojtje të Fëmijëve dhe Grave, i referohet publikimit të të dhënave sensitive të një të miture të abuzuar, por dhe ngjarjeve të tjera të ngjashme, kohët e fundit në transmetimet audivizive.

Në letrën dërguar Autoritetit të Medias Audiovizive, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkon zbatimin e disa dispozitave si:

Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve të respektojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar;Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe, si: gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër;OSHMA-të, në hapësirën informative, nuk duhet të keqpërdorin grupe vulnerabël, por duhet promovuar një qasje pozitive ndaj grupeve vulnerabël (minoriteteve, grave të dhunuara, personave me aftësi të kufizuar etj); në programet kulturore e argëtuese për fëmijët nuk duhet të përdoren terma që nxisin qëndrime paragjykuese; të ndalohet publikimi i reklamave, nëse ato paraqesin haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllim për të diskriminuar për shkaqe të mbrojtura nga legjislacioni shqiptar.
Kjo letër-propozim gjithashtu u është dërguar për dijeni edhe institucioneve të tjera si Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Kuvendit të Shqipërisë, Nënkomisionit për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore, Dhunës në Familje, Kuvendit të Shqipërisë, Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Avokatit të Popullit, Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë, Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë, Shoqata e Mediave Elektronike Shqiptarë, Shoqata e Gazetarëve për Drejtësi

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim letrën e ardhur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dërguar edhe institucioneve të tjera mbi propozimet e tyre për zbatimin e neneve dhe rregullave që përfshihen në Kodin e Transmetimit të hartuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Nisur nga fakti se Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) i është përgjigjur më parë letrës së hapur të Rrjetit të Organizatave në Mbrojtje të Fëmijëve dhe Grave, e për dijeni edhe disa institucioneve të tjera, Këshilli i Ankesave dërgon një përgjigje të dytë për të njëjtën temë referuar letrës së dytë të mbërritur në AMA mbi publikimin nga subjektet audiovizive të detajeve sensitive që bien ndesh me mbrojtjen e të dhënave të fëmijëve por dhe grave. Në letër shkruhet se "Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Këshilli i Ankesave pranë tij, prej muajsh ka marrë rregullisht ankesa po aq edhe letra nga qytetarë dhe agjenci e organizata që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, sa i përket cenimit të parimeve themelore dhe rregullave etike që janë vërejtur gjatë transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, që kanë pasur për subjekt gra apo të mitur".

Ndër të tjera në përgjigjen që Këshilli i Ankesave ka dërguar është cilësuar se raste të abuzimit seksual apo dhunues mbi gratë dhe fëmijët, shpesh janëpublikuar nga subjektet audiovizive por më së shumti nga mediat e shkruara dhe ato online. Ndaj, Këshilli i Ankesave vashdohet më tej në letër, ka vëzhguar seriozisht cenimin e këtyre rregullave etike nisur dhe nga sensibilizimi i lartë që këto ngjarje kanë. Ai ka trajtuar në koherencë të plotë çdo rast të ardhur pranë AMA-s, duke marrë masat përkatëse bazuar mbi ligjin për transmetimet audiovizive nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Pranë të gjitha subjekteve audiovizive, thuhet më tej aty, janë dërguar në të gjitha rastet shkresa ndërgjegjësuese dhe paralajmëruese për transmetimin e disa lajmeve, ku preken të drejtat e të miturve, si rasti i abuzimit të një të miture në një familje në Dibër; rasti i vrasjes së një të mituri në fshatin Palasë; përdhunimi i një të miture nga njerku i saj në Fier; rasti tjetër i një të miture që u dhunua në publik nga një 30-vjeçar në qytetin e Vlorës, etj.

Në letër gjithashtu bëhet me dije se, duke marrë shkas nga disa raportime dhe publikime mediatike, që cenonin rregullat dhe parimet etike të Kodit të Transmetimit, me subjekt të vazhdueshëm fëmijët dhe gratë, në datën 25 Gusht 2016, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka dalë në një Njoftim Publik, me lëndën: "Kujtesë mbi mbrojtjen e të drejtave të të miturve në transmetimet audiovizive". Gjithashtu në letër vihen në dijeni disa përgjegjësi që Autoriteti i Mediave Audiovizive ka marrë përsipër në funksion të sensibilizimit dhe rritjes së profesionalizmit si dy procese të rëndësishme punë të gazetarit. Aty theksohet se AMA ka bashkëpunim të vazhdueshëm me disa institucione si Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve dhe Instituti Shqiptar i Medias. Me këto institucione, AMA ka disa projekte bashkëpunuese që kanë vijuar dhe po vijojnë gjatë këtij viti, pikërisht për çështje që lidhen me raportimin e lajmeve me subjekt gratë dhe të miturit. Ndër projektet e përbashkëta janë: një cikël trajnimesh për performancën e gazetarëve, organizuar në 5 qarqe të vendit si (Elbasan, Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër) me objektivin, përmirësimin e raportimit për të drejtat e fëmijëve si dhe realizimi i një praktike intensive në gazetarinë radiotelevizive, si një mundësi për gazetarët e rinj që të jenë më familjarë dhe profesionistë në shkrimin dhe transmetimin e lajmeve në respekt të lirive dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të të miturve por dhe barazinë gjinore, shmangien e diskriminimit të çdo forme, respektimin e grupeve minore, etj;

Në letër vihet gjithashtu në dijeni se nëpërmjet proceseve të informimit, koordinimit dhe edukimit të tregut në bashkëpunim me aktorët e tjerë, AMA po synon në vijimësi të nxisë realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri dhe që është i përgjegjshëm për nevojat e shikuesve, duke siguruar shumëllojshmëri dhe cilësi të lartë të programeve, sidomos sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Mbrojtja e të miturve dhe e grave në ekran është një nga temat më të rëndësishme në performancën e subjekteve audiovizive. Në përfundim të letrës dërguar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi vihet në dijeni prej Këshillit të Ankesave se Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Ankesave pranë tij, ka në fokus të punës së përditshme respektimin e të drejtave të çdo qytetari në transmetimet audiovizive, dhe në veçanti, mbrojtjen e të drejtave të të miturve dhe të grave.

5

# Ankesa të rrëzuara

Ankesa e paraqitur:

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
| --- | --- | --- |
| **Top Channel** | **Film Artistik** | **11.09.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet përmbajtjes së filmit artistik Intelegjencë, Misione e Sekrete, shfaqur në televizionin Top Channel pasditen e së dielës, datë 11 shtator 2016, rreth orës 17: 52.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve dhe rregullave të transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1. 14 dhe seksioni 9 Këshilli i Ankesave, pika 9.3, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

## 3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi ka dërguar një ankesë në adresën zyrtarë të faqes së AMA-s ku bën me dije se në televizionin Top Channel është shfaqur një film artistik përmbajtja e të cilit shkel normat morale dhe etike të Kodit të Transmetimit. Ai pretendon se transmetimi i këtij filmi me përmbajtje skenash të tilla shkel rëndë normat morale dhe etike të shoqërisë shqiptare.Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa ka të bëjë me shfaqjen e disa skenave erotike gjatë filmit, i cili u shfaq sipas ankuesit në një orar të papërshtatshëm për mjediset familjare

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave konstatoi se sa i përket përshkrimit të skenave erotike, Këshilli nuk mendon se përmbajtja e tyre është e rëndë për shikuesin e thjeshtë qoftë edhe atë familjar. Filmi artistik Intelegjencë, Misione dhe Sekrete është një prodhim kinematografik i shfaqur edhe në kanalet televizive italiane në fasha orari të tilla, gjykuar të përshtatshme edhe për mjediset familjare në shtetin fqinj.
Në këtë aspekt:
Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, nuk e gjykoi të drejtë ankesën e z. Sina, që sipas tij përmbajtja e këtij filmi cenon rregullat dhe normat etike të Kodit të Transmetimit. Në këtë mënyrë, Këshilli e pa të arsyeshme të rrëzojë ankesën e qytetarit në fjalë duke cilësuar se përmbajtja e tij nuk cenon rregullat etike dhe vlerat morale të shoqërisë shqiptare.
Këshilli i Ankesave gjykon se filmi ka një subjekt artistik dhe në përmbajtje të tij është e lejueshme prej producentit që skena të tilla të jenë pjesë e një prodhimi për grupmosha të ndryshme.

Ankesa e paraqitur:

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Data | Program | Subjekti audioviziv |
| --- | --- | --- |
| **12.09.2016** | **Dance With Me** | **Televizioni Klan** |

### 1. Programi

Ankesa i referohet transmetimit të përmbajtjes së spektaklit artistik "Dance With Me", shfaqur në TV KLAN mbrëmjen e së hënës, datë 12 shtator 2016, rreth orës 21: 15. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa ka të bëjë me shfaqjen e disa skenave jo fort të përshtatshme sa i përket rregullave dhe normave etikeqë shfaqen gjatë transmetimit të programit argëtues për mjediset familjare.

### 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve dhe rregullave të transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1. 4, 1. 7 dhe seksioni 9 Këshilli i Ankesave, pika 9.3, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

### 3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi ka dërguar një ankesë në adresën zyrtarë të faqes së AMA-s ku bën me dije se në Televizionin Kombëtar Klan gjatë transmetimit të spektaklit Dance With Me janë shfaqur disa skena që cenojnë normat morale dhe etike të Kodit të Transmetimit. Ankuesi shkruan se ndihet i shqetësuar para shfaqjes së këtyre skenave me të tillë përmbajtje, që transmetohen në një orar krejt të papërshtatshëm për mjediset familjare. Ai pretendon se transmetimi i këtyrë episodeve nga një televizion kombëtar shkel rëndë normat morale dhe etike të shoqërisë shqiptare.

### 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik dhe ankesës së dërguar nga qytetari duke iu referuar edhe Kodit të Transmetimit seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1. 4, 1. 7 dhe seksioni 9 Këshilli i Ankesave, pika 9.3, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", Këshilli vendosi ta refuzojë ankesën duke konstatuar se:

- pjesa e spektaklit për të cilën ka mbërritur ankesa imiton larjen (lavazhin) e një makine, shoqëruar me muzikë dhe koreografi;

- duke patur parasysh kontekstin e spektaklit argëtues, nuk vihen re elementë të ekzagjeruar që mund të jenë subjekt i Kodit të Transmetimit.

*Në këtë aspekt:*

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, nuk e gjykoi të drejtë ankesën e z. B. J., që sipas tij cenonte rregullat dhe normat etike të Kodit të Transmetimit. Në këtë mënyrë, Këshilli e pa të arsyeshme të rrëzojë ankesën e qytetarit në fjalë duke cilësuar se përmbajtja e saj nuk i qëndron cenimit të rregullave të etikës dhe moralit në shoqërinë shqiptare.

Ankesa e paraqitur nga: **Z. B.B.**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Subjekti audioviziv | Programi | Data |
| --- | --- | --- |
| **Televizioni Publik Shqiptar** | **Film Artistik** | **17.09.2016** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet transmetimit të përmbajtjes së filmit artistik Udhëtim i Trazuar, shfaqur në Televizionin Publik Shqiptar gjatë pasdites, dt. 17. 09. 2016, rreth orës 15: 02. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa ka të bëjë me shfaqjen e disa skenave erotike gjatë filmit, i cili jepet në një orar të papërshtatshëm për mjediset familjare, pasi mes tyre ka dhe fëmijë e persona të ndryshëm nga kategoria e moshës.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve dhe rregullave të transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1. 14 dhe seksioni 9 Këshilli i Ankesave, pika 9.3, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

## 3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi ka dërguar një ankesë në adresën zyrtarë të faqes së AMA-s, info@ama.gov.al ku bën me dije se në Televizionin Publik Shqiptar është shfaqur një film artistik përmbajtja e të cilit shkel normat morale dhe etike të Kodit të Transmetimit. Ai pretendon se transmetimi i këtij filmi me përmbajtje skenash të tilla shkel rëndë normat morale dhe etike të shoqërisë shqiptare.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave konstatoi se sa i përket përshkrimit të skenave erotike, Këshilli nuk mendon se përmbajtja e tyre është e rëndë për shikuesin e thjeshtë, qoftë edhe atë familjar. Filmi artistik Udhëtim i Trazuar përshkruan historinë e marrëdhënies së tronditur të një nëne dhe një djali dhe aty shfaqet një skenë e vetme kur të dy bashkë ndalojnë të detyruar prej rrethanave në një bar për të rritur. Edhe pse e vetmja skenë, Televizioni Publik Shqiptar ka vendosur publicitet në këtë pjesë të filmit.

*Në këtë aspekt:*
Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, nuk e gjykoi të drejtë ankesën e z. Bala, që sipas tij cenonte rregullat dhe normat etike të Kodit të Transmetimit. Në këtë mënyrë, Këshilli e pa të arsyeshme të rrëzojë ankesën e qytetarit në fjalë duke cilësuar se argumentet e z. Bala nuk i qëndrojnë cenimit të rregullave të etikës dhe moralit në shoqërinë shqiptare.
Këshilli i Ankesave gjykon se filmi ka një subjekt artistik dhe në përmbajtje të tij është e lejueshme prej producentit që skena të tilla të jenë pjesë e një prodhimi për grupmosha të ndryshme.

Ankesa e paraqitur nga: **Z. G. S.**

Dërguar në: *info@ama.gov.al*

| Data | Program | Subjekti audioviziv |
|---|---|---|
| **05.12.2016** | **Dance With Me** | **Televizioni Klan** |

## 1. Programi

Ankesa i referohet transmetimit të përmbajtjes së spektaklit artistik "Dance With Me", shfaqur në TV KLAN mbrëmjen e së hënës, datë 5 dhjetor 2016. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa ka të bëjë me disa komente të çiftit të artistëve Jessy dhe Vicky, të cilët gjatë performancës së tyre sipas ankuesit, kanë denigruar dhe stigmatizuar dinjitetin e komunitetit rom.

## 2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve dhe rregullave të transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1.3, Këshilli i Ankesave, hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

## 3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi ka dërguar një shkresë në adresën zyrtare të faqes së AMA-s ku bën me dije se në Televizionin Kombëtar Klan gjatë transmetimit të spektaklit Dance With Me janë bërë disa komente që cenojnë parimet themelore të Kodit të Transmetimit. Ai shkruan se ndihet i fyer si përfaqsues i komunitetit rom me komentet e artistëve gjatë perfomancës së tyre duke denigruar, stigmatizuar dinjitetin e komunitetit rom. Ai pretendon se të tilla komente në një televizion kombëtar shkelin rëndë normat etike, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

## 4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik dhe ankesës së dërguar nga qytetari duke iu referuar edhe Kodit të Transmetimit seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1. 3, Këshilli i Ankesave vendosi ta refuzojë ankesën duke konstatuar se:

- në fillim të performancës së tyre, çifti i artistëve Jessy dhe Vicky sollën në skenë disa detaje nga dasmat shqiptare, shoqëruar në sfond më muzikë dasmash, ndërthurur me improvizimin e disa zakoneve që duhet të përmbushin dhëndri dhe bashkëshortja e tij;

- më tej, performanca e dy artistëve në skenë, shoqëruar nga 10 balerinë, vijon me kërcimin e një kënge me motive rome.

- pas përfundimit të kërcimit nga dy artistët dhe balerinët që i shoqërojnë, në pritje të vlerësimit nga juria, ka shkëmbime batutash midis artistëve. Autorët e programit, dy artistët për të cilët ngrihet ankesa, dhe konkurrentët e tjerë në këtë spektakël janë kujdesur të sjellin në skenë momente dhe detaje nga dasmat dhe gëzimet e komunitetit rom por pa asnjë qëllim të stigmatizohet komuniteti rom. Madje gjatë spektaklit një nga anëtarët e jurisë, artisti Albi Nako, shprehet me respekt ndaj komunitetit duke e vlerësuar edhe nga ana artistike sa i përket përmbajtjes artistike të kulturës së tyre.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave mendon se nuk ka asnjë element që denigron apo stigmatizon komunitetin rom gjatë minutave të spektaklit DËM. Këshilli nuk e gjykoi të drejtë ankesën e G. S., që sipas tij cenonte dinjitetin e komunitetit rom.
Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Ankesave në veçanti ka risjellë në vëmendje të subjekteve herë pas here përmbajtjen e Kodit të Transmetimit me parimet themelore të tij, duke i paralajmëruar të gjithë transmetuesit audiovizivë se çdo shkelje e tij do të shoqërohet me masa ligjore nga ana e Autoritetit.

# Anketë mbi performancën e Kodit të Transmetimit

Organizuar nga AMA - nëntor 2016

Kampioni: 130 vetë

Ky anketim bëhet me kërkesën dhe sipas projektit të hartuar nga Këshilli i Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive. Ai i besoi Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës zbatimin e metodologjisë mbi hulumtimin e tregut për të përcaktuar qëndrimet e publikut ndaj një sërë çështjesh me rëndësi dhe tepër sensibilisuese për të.

Bazuar këtu, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s falenderon fillimisht Autoritetin e Mediave Audiovizive që duke kuptuar rëndësinë e këtij anketimi nxiti më tej vullnetin institucional për ta ndërmarrë atë.

Një falenderim i vecantë shkon më pas për shefin e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, As. Prof. Dr Mark Marku dhe gjithë ekipin e tij të punës, i cili më dashamirësi dhe profesionalizëm brenda një kohe të shkurtër që nga fillimi i këtij procesi e mbështeti atë duke i dhënë një ndihmë të pakursyer në trajtimin e tij sa teorik aq dhe statistikor.

Ky anketim nuk mund të kryhej pa mbështetjen dhe pjesmarrjen e palodhur dhe profesionale të mjaft studentëve që morën pjesë në ekipet e anketimit dhe intervistave në terren. Me këtë rast edhe ata i falenderojmë thellësisht, së bashku me ekipin që përballoi punën e lodhshme të leximit të të dhënave anketore dhe hedhjes së tyre në formën informatike të trajtimit.

Mbledhja e të dhënave në terren u krye nga ekipet e anketimeve dhe intervistimeve në terren të drejtuar nga  MA Ervin Goci.

*Ky anketim kaloi disa etapa:*

***Etapa e parë:*** Njohja me metodologjinë dhe përpilimi i dokumentave formatues të anketës.

***Etapa e dytë:*** Krijimi i grupeve të anketimit në terren.

***Etapa e tretë:*** Mbledhja e të dhënave të anketës në terren.

***Etapa e katërt:*** Interpretimi i të dhënave dhe përpilimi i raportit përfundimtar. Kjo anketë është fryt i një pune shkencore dhe ekspertize kolektive, ku cdokush nga pjesmarrësit ka kryer me angazhim të plotë detyrat e tij.

Grupi i punës është i ndërgjegjshëm se në këtë raport paraqiten me objektivitet të dhënat kyesore si dhe përfundimet që dalin prej tyre. Nëpërmjet konstatimeve paraqiten disa sugjerime primare.

Një bazë e madhe e të dhënave të interpretuara shoqërojnë raportin përfundimtar por nuk duhet të harrojmë se asnjëherë në një kërkim të tillë të vogël anketor nuk mund të pretendohet saktësia absolute. Gjithmonë gjykohet me përafrime që kemi dashur të jenë sa më afër të vërtetës. Gjithsesi shpresojmë që njohja me të dhënat e këtij anketimi si dhe interpretimi i tyre bashkë me sugjerimet që propozohen, të shkojnë modestisht në shërbim të zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

## 1. Aspekte metodologjike

Për të pasur një rezultat sa më afër të vërtetës reale lidhur me perfomancë ne Kodit të Transmetimit nga ana e subjekteve audiovizive, metodologjia e këtij anketimi u mbështet kryesisht në parimin e krahasimit dhe kryqëzimit të të dhënave.Krahasimi i të dhënave është bërë në shumë plane.

Së pari, anketimi është bërë duke marrë perceptime nga individë të ndryshëm, të cilët në varësi të formimit të tyre arsimor, identitetit gjinor dhe grupmoshave sigurisht paraqesin një perceptim dhe vlerësim të ndryshëm të perfomancës së Kodit të Transmetimit dhe cështjeve të tjera sensitive[1] që ai trajton në subjektet audiovizive. Ashtu sikundër ndodh edhe në modelet europiane që u përdorën si udhërrëfyes metodologjikë në punën e kryer, në këtë anketim modest, analiza se sa njihet apo zbatohen aktet nënligjore të Kodit të Transmetimit u shqyrtua nga pikpamja e "perceptimit" të saj nga një grup i kufizuar personash.

Së dyti, të gjitha të dhënat vijnë ekskluzivisht nga anketimi i 130 personave përqëndruar në kryeqytetin shqiptar, Tiranë. Për shkak se Tirana ofron numrin më të madh të banorëve dhe për nga statusi social ofron një diversifikim kulturor gjithë planësh, mbushur me zona informale krijuar si pasojë e nevojës së njerëzve të varfër për të kërkuar alternativa punësimi dhe jetese pranë qyteteve të mëdha, ky anketim, i pari në llojin e tij organizuar nga Këshilli i Ankesave me mbështetjen e AMA-s, u përqëndrua pikërisht këtu.Në ekspertizën që përmban ky raport u mendua të shtoheshin disa teknika që të mund të kuptohet qartë perfomanca e Kodit të Transmetimit në subjektet audiovizive në mënyrë që më pas të arriheshin disa përfundime fillimisht për t'i bërë të ndërgjegjshme subjektet për situatën dhe më pas pretenduese për të pë rmirësuar ndjeshëm atë.

## 2. Mbi perceptimet lidhur me Kodin e Transmetimit

Anketa, rezultatet e së cilës po ju prezantojmë, synoi të sigurojë një perceptim tërësor mbi situatën aktuale të medias në Shqipëri, e në veçanti mbi punën e gazetarëve; lirinë që ata kanë për t'u shprehur; raportin e ekranit me qytetarët dhe aksesin e këtyre të fundit, interferencat politike në televizione, etj.

Një pikë e rëndësishme e anketimit ishte dhe thithja e mendimeve/ perceptimeve mbi shkelje të mundshme të Kodit të Transmetimit në programet televizive, pra nëse ka apo jo fyerje, shpifje dhe cenim dinjiteti, dhe nëse ka, në ç'shkallë janë ato shkelje. Duke rikujtuar se Këshilli i Ankesave (KA) pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) është "gardiani" i mbrojtjes së etikës në transmetimet audiovizive, edhe kjo pjesë e anketimit merr rëndësi të veçantë, jo vetëm si pjesë e së tërës, por edhe duke u plotësuar më tej me pika të nxehta të debatit të sotëm mbi mediat, ku në fokus janë emisionet - e jo vetëm emisionet - që cenojnë psikologjinë dhe edukatën e fëmijëve apo keqpërdorimi i imazhit të fëmijëve në ekran, përkundër anës tjetër të medaljes, nëse ka bollshëm emisione argëtuese për fëmijët në ekranet shqiptare.

Për të marrë një perceptim sa më realist, anketimi është shtrirë në të dyja gjinitë (femra-meshkuj), në disa nivele arsimimi (tetëvjeçar, të mesëm, universitar dhe pasuniversitar) si dhe në tri grupmosha (18-34 vjeç; 35-49 dhe mbi 50 vjeç).

(1) Me "cështje sensitive" të Kodit të Transmetimit në këtë raport do të kuptojmë përmbajtjen e atyre pikave dhe akteve nënligjore të cilat bazuar mbi ankesat e mbërritura janë cenuar dhe prekur më së shumti nga subjektet audiovizive. Nisur nga cështjet e sipërpërmendura Këshilli i Ankesave gjithashtu duke qenë vazhdimisht në procesin e zhvillimit të një Kodi i cili ka ambicien të ruajë fort dhe të mbrojë cështjet etike në media, si dhe të përmirësohet më tej e sheh të nevojshme të nisë një anketim mbi hulumtimin e tregut për të përcaktuar qëndrimet e publikut ndaj një sërë çështjesh me rëndësi dhe tepër sensibilisuese për të, të cilat po i përmendim :- respektimi i dinjitetit dhe i të drejtave të tjera themelore të njeriut; - mbrojtja e të miturve; - e drejta për informacion dhe sensibilizim të opinionit publik; - respektimi i normave morale dhe etike në programet televizive.

Sigurisht që me këtë shtrirje të anketës në tri rrafshe nuk është synuar thjesht marrja e përgjigjeve të diversifikuara, por edhe e një pamjeje mbi gjendjen e medias shqiptare, lirinë e gazetarëve, emisionet televizive dhe problemet që shfaqen në to, përmes disa këndvështrimeve: gjinore, të nivelit arsimor dhe atij moshor.

Ka disa gjetje interesante të këtij anketimit, që do të përpiqemi t'i rendisim shkurtimisht më poshtë, pa pretenduar shterimin e plotë të tyre, që është në varësi edhe të perceptimit të kujtdo që do të ketë në dorë këtë material.

**-Liria që kanë gazetarët për t'u shprehur në punën e tyre**

Vihet re sa më pak të arsimuarit mendojnë se gazetarët kanë pak liri. Pra, sa më pak i arsimuar, perceptimi është negativ. Ky perceptim merr nota pozitive tek të anketuarit me arsim më të kualifikuar;

**-Zëri i qytetarëve në ekran**

Edhe perceptimi mbi këtë temë mund të konsiderohet një gjetje interesante. Pasi ndryshe nga debatet e ndryshme që hasim në jetën e përditshme, shumë prej të anketuarve - duke iu referuar mesatares së përgjithshme - mendojnë se qytetari ka akses në ekran. Ndërkaq, përgjigjet sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe grupmoshave ofrojnë pamje mikse mbi qasjen e zërit qytetar në ekran. "Përplasja", nëse mund ta konsiderojmë të tillë mund të ketë një shpjegim: ndoshta duhet parë se për ç'qëllime përdoret zëri i qytetarëve në ekran.

**-Shkeljet etike në programet televizive**

Duket se kjo temë është "thembra e Akilit" në televizionet tona. Thuajse të gjitha grupet e intervistuara bashkohen në një pikë: situata nuk është e mirë.

Është e qartë se fyerjet, shpifjet apo dhe cënimi i dinjitetit janë të pranishme në emisionet televizive dhe këtë e mendojnë pjesa dërrmuese e të anketuarve, përkundrejt vetëm 16% që mendojnë ndryshe.

Por edhe më interesant është përqindja e femrave, vetëm 2, që mendojnë se "respektohet dinjiteti". Duket se kjo gjini që është edhe më pranë ekraneve televizive ndjehet e cenuar nga programet televizive që ajo ndjek.

**-Fëmijët dhe emisionet që i cenojnë**

Edhe kjo është një temë e rëndësishme e këtij anketimit, që ka sjellë shifra interesante. Perceptimi thuajse është i njëjtë se dhe për shkeljet etike në tërësi nga emisionet televizive. Rreth 46% e të anketuarve vlerësojnë me notën 1 dhe 2 - nota këto të konsideruara të ulëta - duke përcaktuar se ka shumë emisione që cenojnë psikologjinë e fëmijëve. Rreth të njëjtave përqindje për këtë perceptim negativ ofrojnë edhe përgjigjet sipas gjinisë, nivelit arsimor të të anketuarve dhe moshave të ndryshme, pjesë e kësaj ankete.
Sigurisht që nuk mund të bëjë dallim, si pjesë integrale e kësaj çështjeje "të nxehtë" pyetja nëse ka keqpërdorim në ekran të imazhit të të miturve apo nëse ka bollshëm emisione argëtuese për fëmijët. Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë mendim negativ për këto çështje. Sipas tyre, ka keqpërdorim në ekran të imazhit të fëmijëve dhe televizionet nuk kanë aq sa do duhej emisione argëtuese për fëmijët.
